



# MALL PËR Resulin

(Paqja e Zotit qoftë mbi të)



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Erzen Carja

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXII i botimit  
Nr. 09 (484)  
Shtator, 2023

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.

## PËRMBAJTJA

4 Mall për Resulin (a.s.) / Mehmet Disha

6 Lindja e profetit Muhamed (a.s.), fanar ndriçues i njerëzimit / Dorian Demetja

8 Lajme / Aktivitete



12 Dobitë e Mevludit / Arben Halluni

16 Si e adhuronin Allahun dijetarët dhe evlijatë? / M. Fetah Resuloglu

20 Ftesë për të përbushur parimet kryesore të Islamit / M. Jusuf Kandeheuli

22 Lexo / Hysen Kobellari

24 Tregimet e profetëve në Kur'anin Famëlartë / Abdulah Bulku

26 Vlerësimi i diturisë sipas fesë Islame / Xhema Bala

28 Lindja e Profetit / Retrospektivë




32 Hafiz Ismet Dibra (1886-1955) / Personalitet

34 Efektet biologjike të telefonit celular / Ali Tombak

36 Disa çështje rreth abdesit të gratë / Fatma Karaj

38 Respekti ndaj emrit të Muhamedit (a.s.) / Redaksia





# MALL PËR Resulin

(Paqja e Zotit qoftë mbi të)

Janë disa gjëra që nuk i prek koha, që mbeten jetësore dhe të gjalla, që kalimi i viteve e i shekujve vetëm sa i forcon dhe i vërteton. I tillë mbetet mesazhi i K'uranit dhe tërësia e ajeteve të shpallura, që vërtetojnë fuqinë absolute e të pakufishme të Allahut si i Gjallë dhe i Përjetshëm. E po ashtu, mbetet edhe mesazhi i të Dërguarit të Allahut, Muhamedit (a.s.), i cili qe dërguar si mëshirë për njerëzimin dhe nën urdhrat e Krijuesit, I Cili e mësoi atë dhe i dha shpallje me një mesazh të qartë e që do të zgjasë deri në fundin e kohës.

Vitet, vetëm sa e gjallëruan mesazhin e Resulit (a.s.), duke vërtetuar Kur'anin që erdhi nëpërmjet zemrës së tij, dhe fjalët e këshillat e tij ndër shekuj më pas. Nëse foli për shëndetin, foli qartë dhe shekuj i thanë "sadekte", saktë fole. Nëse foli për profeci të ndryshimeve dhe lehtësimeve që do të vinin në shekujt më pas, prapë historia i tha, saktë fole. Nëse foli për nevojën e besimtarit që duhet të gjejë rrugën për te Zoti dhe të ushqejë zemrën, shpirtin e mendjen me nurin e Kur'anit, prapë saktë foli. Dhe pas kaq shekujsh, ne qëndrojmë të lumtur e të përmalluar që Zoti në këtë jetë na dha mundësinë ta njohim Resulin, që përpqemi të jemi umeti i tij, që e ndjekim Sunetin e pastër dhe Islamin madhështor, duke i thënë me gjithë shpirt, Muhamedit (a.s.) 'sadekte ja RasulAllah'.

Po, ai (a.s.) ishte më i miri i njerëzimit. Shembulli i tij ishte më i përsosuri ndër njerëz. Sillej urtë e butë me këdo dhe kishte zgjidhje që i qenë mësuar prej Zotit për çdo problem që u lindte besimtarëve që jetuan bashkë me të asokohe, dhe që fjalët e këshillat e tij janë akoma zgjidhje dhe kanë rrugëdalje edhe për besimtarët sot e do të kenë deri në ditën e fundit. Njerëzit i vinin përpara me hallet e dertet e tyre dhe i thonin 'Si t'ja bëjmë, o i Dërguar i Allahut?', dhe Resuli (a.s.) priste udhëzimin e Zotit dhe menjëherë vinte zgjidhja, e fjalët rridhnin ëmbël prej

buzëve të tij, duke lehtësuar zemrat e jetët e besimtarëve.

Sikur të mund të flisnim me ty një copë herë, një grimë, të mund të kishim at' çastin e lumtur të mundësisë për të vështruar një herë të vetme fytyrën tënde rrezëllitëse ja ResulAllah! Sikur për një çast të mund të të kundronim përballë duke të dhënë selam në vetën e dytë, 'Selam ty ja Resul', dhe të na përgëzoje me pohimin tënd.

Ndoshta vitet kanë prekur shumë gjëra, dynjaja është lidhur e qepur ngushtë pas zemrave tona, dhe ndoshta jemi lëkundur sa e sa herë pas ëndjeve të iluzionta të kësaj dynjaje, ama prapë Allahu na ka begatuar me mirësinë e kthimit sërish të dy shtyllat kryesore, te Kur'ani, te Resuli, dy dyert e mëshirës që ndriçojnë udhët përpara në jetën e besimtarëve. E ne as nuk e dimë e nuk është çështje e jona të përcaktojmë a ka zemra besim a jo, ama shpresa se Zoti do të na i falë gabimet, duke na stolitur zemrat me besim, duke na pastruar nga urrejtja dhe errësira e gjynaheve, e duke na orientuar drejt horizonteve që ti Resul i dashur, hape për ne në këtë botë e në botët shpirtërore, nuk shuhet. Ti na ke mësuar se gjendja e besimtarit është mes frikës dhe shpresës, e ne qëndrojmë sot pas kaq shekujsh duke shpresuar dhe duke ndjekur gjurmët e të dashurit të Zotit, gjurmët e tua ja ResulAllah, dhe ti tashmë çdo ditë vërtetohesh nga miliona zemra e shpirtira, që të dërgojnë salavate me miliarda herë, si falenderim ndaj Allahut që të solli si mëshirë për botët.

Paqja dhe selamet më të përzemërta, më të vazhdueshmet e më të përsorurat qofshin mbi Ty ja ResulAllah, mbi familjen tënde të pastër, mbi shokët e tu besnikë dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin dhe do ta ndjekin rrugën tënde deri në ditën e Gjykimit.

Amin!

**Mehmet Disha**

# LINDJA E PROFETIT MUHAMED (A.S.), *Fanar ndriçues i njerëzimit*



Për këtë vit, shtatori i datës 26 shënon lindjen e bekuar, lindjen e vulës së profetëve, Hz. Muhamed (a.s.). Të gjithë kombet e popujt e ndryshëm, sipas rastit e vendit, festojnë ditëlindjen e njerëzve të tyre të shquar, të dalluar për vepra trimërie, bamirësie, letrare, filozofike e shkencore, duke i shërbyer jo vetëm kombeve përkatëse, por edhe mbarë njerëzimit. Këta njerëz të mëdhenj, jo vetëm i kanë sjellë dobi e përfitim popujve të ndryshëm, por bëhen më vonë shembuj për brezat e ardhshëm që të pasojnë gjurmët e tyre. Por, nëse ekziston një ngjarje, e cila mund të shkaktojë me të vërtetë gëzim dhe pjesëmarrje të përbotshme, ajo, padyshim, është lindja e Profetit të bekuar, Muhamed Mustafasë (a.s.). Ai i solli mbarë botës mesazhin e paqes dhe harmonisë në atë kohë, kur ajo kishte nevojën më të madhe për të.

Hz. Muhamedi a.s. erdhi në këtë jetë ditën e hënë, më datë 12 të muajit Rebiul-evvel, të vitit 571. Ditëlindja e të Dërguarit të Allahut, profetit të Islamit, është ngjarja më e rëndësishme në të gjithë historinë e njerëzimit, sepse nëpërmjet këtij burri, i madhi Zot do të derdhte mëshirën e Tij mbi të gjitha botët, do të ndriçonte mendjet e nxira nga padija e politeizmit, do të lartësonte dhe do të vinte personalitetin e njeriut në vendin që i takon. Kjo lindje është një favor i Allahut për të gjithë njerëzimin. Zoti ynë i Lartë urdhëron kështu në Kur'an: "Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar."<sup>1</sup>

Shikoni bujarinë, ndihmën dhe favorin e Allahut, që u dërgon njerëzve për profet njërin nga mesi i tyre, nga origjina e tyre, i cili ndan me ta të njëjtat ndjenja e mendime, i cili është udhëzues e prijës i tyre në rrugën që shkon te e Vërteta, i cili mund të dalë në krye të tyre nëse është nevoja për imam, i cili mund të hipë në minber nëse është nevoja për hatib, i cili mund të vejë vulën e të presë monedha nëse është nevoja për një drejtues shteti, i cili mund t'i komandojë ata në mënyrën më të përkryer nëse është nevoja për t'i komanduar...

Profeti Muhamed a.s. është profeti i fundit që Allahu i dërgoi njerëzimit. Ai është njeriu më i lartë, më me vlerë dhe më i respektuari nga të gjitha krijesat e tjera. Ai është profeti i mëshirës dhe i dashurisë. Allahu e dërgoi atë si mëshirë për mëkatarët e të devotshmit, për burrat e gratë, për fëmijët e të moshuarit, për besimtarët e mohuesit, për njerëzit e xhindet. Madje, Allahu praninë dhe ekzistencën e Muhamedit a.s. në tokë, e bëri garanci dhe siguri për të gjitha krijesat, kur thotë: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët."<sup>2</sup>

Profeti i fundit është krijesa më e dashur tek Allahu (xh. sh.) dhe, duke qenë i tillë, ashtu duhet të jetë edhe për ne që pretendojmë se ndjekim rrugën e tij. Dashuria për profetin a.s. është njëkohësisht dhe dashuri për bukurinë e fisnikërinë e karakterit të tij, për drejtësinë, modestinë dhe forcën e brendshme të njeriut, të cilat profeti i zotëroi në shkallën më të lartë. Myslimanët obligohen që dashurinë ndaj tij ta vendosin mbi dashurinë ndaj çdo krijese tjetër, përfshi këtu veten dhe të dashurit e tyre. Për këtë, në hadithin e transmetuar nga Enesi (r.a.), Profeti (a.s.) ka thënë: "Askush prej jush nuk do të jetë besimtar i vërtetë, derisa të bëhem për ju më i dashur se prindërit tuaj, fëmijët tuaj dhe të gjithë njerëzit e tjerë."<sup>3</sup>

Profeti ishte njeriu i paqes e i qetësisë. Ne e dimë dhe e besojmë kategorikisht se mesazhi që ai përcolli, gjithashtu ishte një burim paqeje e qetësie dhe historia është dëshmitarja më e madhe për këtë. Ja pra, e vetmja zgjidhje për ta bërë njerëzimin që ta shijojë përsëri këtë paqe e qetësi, është që t'ua bëjmë të njohur njerëzve Profetin dhe mesazhet që solli ai. Sepse, në raport me sa do të njihet ai dhe në sajë të asaj dashurie, do të ndërrojë gjendja e shoqërisë. Kështu, njerëzimi do të shpëtojë së bredhuri pa drejtim e së qeni lodër në duart e kohës, do të shpëtojë nga mjerimi i ndëshkimit në të dy botët dhe do të ngjitet në qiellin e të qenit njeri.

Duke përkujtuar ditëlindjen e tij, nuk bëjmë gjë tjetër veçse i bëjmë thirrje vetes, që të njihemi sa më mirë me jetën e Profetit tonë. Duke njohur figurën e pastër dhe të bekuar të Hz. Muhamedit (a.s.) dhe duke i vënë vetes detyrë të zbatojmë urdhrin e Allahut (xh.sh.) për të pasur atë model në jetën tonë, do të bëhemi më njerëzorë dhe, me lejen e Allahut, do të jemi myslimanë të vërtetë, që do të thotë njerëz të bindur me vetëdije për ta kaluar jetën e kësaj bote në përputhje me urdhrat e Kur'anit dhe porosinë e të Dërguarit të Allahut.

Jetesa e Profetit (a.s.) nga njëra anë na nxit të lakmojmë arritjen e përsosmërisë dhe nga ana tjetër na ndihmon të pranojmë paaftësinë tonë për të qenë të pagabueshëm duke na shtyrë të jetojmë në paqe me veten si robër të penduar të Zotit, me shpresë në mëshirën e madhe të Tij. Që besimi ynë të jetë i shëndoshë dhe i plotësuar, duhet ta duam Profetin tonë duke ndjekur rrugën e tij dhe duke u lutur për të sipas urdhrat kuranor: "Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me selam"<sup>4</sup>.

**Dorian Demetja**

1. Al 'Imran, 164  
2. Enbija, 107

3. Buhariu-Muslimi  
4. Ahzab, 56



## 1

**KRYETARI SPAHIU VIZITË KORTEZIE NË AMBASADËN E KUVAJTIT**


Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujari Spahiu, zhvilloi me datë 01.08.2023 një vizitë kortezie në ambasadën e Kuvajtit, ku u prit nga ambasadori z. Fajsal Sulejman el-Musejlim.

Gjatë këtij takimi, z. Spahiu, e njohu ambasadorin Musejlim me institucionin e KMSH-së dhe rolin e tij në shoqërinë shqiptare përgjatë historisë.

Gjithashtu kryetari Spahiu e falenderoi z. Musejlim për kontributin e vazhdueshëm të shtetit dhe popullit të Kuvajtit në ndihmë të islamit, myslimanëve dhe në fushën e bamirësisë në vendin tonë prej tri dekadash.

Nga ana e tij, z. Ambasador i Kuvajtit e falenderoi kryetarin Spahiu për vizitën dhe shprehu gadishmërinë për të zhvilluar më tej marrëdhëniet dypalëshe ndërinstitucionale, si dhe për të mbështetur KMSH-në në zhvillimin e marrëdhënieve të saj me institucione të ndryshme qeveritare në shtetin e Kuvajtit.

Gjatë kësaj vizite, kryetari Spahiu, u shoqërua nga dr. Jamal al-Safarty, këshilltar i kryetarit për marrëdhëniet me Botën Arabe, z. Edison Hoti drejtor i Vakf-Investimeve dhe Financës pranë KMSH.







## 2

**KRYETARI I KMSH MERR PJESË NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE ME TEMË "KOMUNIKIM DHE INTEGRIM" NË ARABINË SAUDITE**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, udhëtoi për në Mekë/Arabia Saudite, ku mori pjesë në konferencën ndërkombëtare me temë "Komunikim dhe Integrim".

Kryetari Spahiu, në këtë konferencë, merr pjesë me ftesë të posaçme të Shkëlqesisë së Tij, Abdul-Latif bin Abdul-Aziz Al Shejkh, Ministër për Çështjet Fetare në mbretërinë e Arabisë Saudite, me të cilin zhvilloi edhe një takim të veçantë.

Kryetari Spahiu dhe Shkëlqesia e Tij, Abdul-Latif bin Abdul-Aziz Al Shejkh folën për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që ekziston mes Komunitetit Mysliman dhe Ministrisë së Çështjeve Fetare Saudite.

Fokusi i bisedës ishte zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në të tjera fusha me interes të përbashkët dhe me një qëllim të vetëm, shërbimin ndaj Islamit dhe përcjelljen e pastër e të drejtë të mesazhit në vendet respektive dhe mbarë botën.





### 3

#### VIZITË KORTEZIE E MINISTRIT TË BRENDSHËM, Z. TAULANT BALLA

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me datë 31.08.2023, priti në një vizitë kortezie Ministrin e Brendshëm, z. Taulant Balla.

Kryetari i KMSH-së vlerësoi bashkëpunimin mes dy institucioneve për sa i përket garantimit të sigurisë publike e kombëtare dhe shprehu gatishmërinë për të vijuar këtë bashkëpunim në vijim.

Z. Balla nga ana e tij rikonfirmoi mbështetjen e Ministrisë së Brendshme dhe theksoi se bashkëpunimi ndër-institucional në shërbim të qytetarëve do të vijojë të jetë i ngushtë edhe në vazhdim.





## 4

## NIS ZYRTARISHT VITI I RI SHKOLLOR NË MBARË VENDIN

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, ishte i pranishëm në ceremoninë e çeljes në Medresenë e Tiranës, ku përpos tij në këtë ceremoni ishin të pranishëm Drejtori i Medresesë, z. Ndrichim Gjimi, stafi pedagogjik i këtij institucioni arsimor dhe nxënësit e ciklit fillor dhe atij të mesëm.

Në fjalën hapëse, Drejtori i Medresesë, z. Gjimi, u shpreh entuziast në fillimin e një tjetër viti shkollor plot me sfida duke uruar të gjitha palët për sa më shumë suksese dhe mbarësi.

Ndërsa Nënkrjetari Bica, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i uroi ata për një vit sa më të bereqetshëm në arritjet e objektivave të radhës, parashtrori rëndësinë e medresesë si një institucion i veçantë arsimor.

"Medreseja, me mësuesit e saj të shkëlqyer dhe të përkushtuar ka dhjetëra vite që kontribuon në realizimin e dëshirave të prindërve tanë, në mënyrë që fëmijët e tyre të jenë sa me të ditur, suksesshem dhe të virtytshëm. Për disa nga ju ky është viti i dytë apo i tretë, e për disa të tjerë është viti i parë që keni zgjedhur ta vazhdoni rrugëtimin tuaj të dijës në këtë shkollë të mrekullueshme me një staf të përkushtuar. Jam i bindur se keni bërë zgjedhjen e duhur për të ardhmen tuaj." – u shpreh ai.

Pas përfundimit të ceremonisë së çeljes së këtij viti të ri shkollor, nxënësit e medresesë vijuan me shpërndarjen nëpër klasat përkatëse ku edhe filluan ditën e parë të shkollës për këtë vit.



# Dobitë e Mevludit

Në këto ditë ne përjetojmë një nga evenimentet më madhështore Islame me të cilin krenohet dhe gëzohet çdo mysliman, përjetojmë një nga festat më të lumtura Islame, ku secili besimtar çdo vit lumturohet shpirtërisht. Ky është mevludi (ditëlindja) e Pejgamberit tonë të nderuar, mësuesit dhe edukatorit tonë të respektuar, udhëheqësit dhe imamit tonë të dashur për të gjitha zemrat e singerta të besimtarëve. Muhamedi, i biri i Allahit (Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të!), duke qenë vula e mbarë të Dërguarve dhe Pejgamberëve shndriti gjithë rruzullin tokësor me shembullin e tij konkret në të gjitha aspektet e kësaj jete materiale. Allahu (xh.sh.) thotë në Kur'anin e shenjtë: **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh Allahun”.** [El-Ahzabe: 21]

Është e pamundur që në këtë artikull të përshkruhet dhe të flitet për një burrë kaq të madh Islam, për këtë figurë të nderuar për të gjithë njerëzit dhe krijesat në këtë botë materiale. Megjithatë, le të mundohemi të hedhim sadopak dritë mbi këtë zotëri, i cili jo vetëm që është nderuar, respektuar dhe është ndjekur rruga e tij profetike nga myslimanët në përgjithësi, por, siç dihet realisht, ai nderohet dhe vlerësohet edhe nga ithtarë të besimeve të ndryshme, të cilët i japin merita për të gjitha çështjet dhe respektohet me nderim nga dijetarë dhe shkencëtarë të mëdhenj, nga politikanë dhe filozofë të shquar, nga akademikë dhe letrarë të njohur të botës. Në të vërtetë lindja e këtij njeriu madhështor ishte shpëtim për mbarë njerëzimin, si: në çështjen e besimit, adhurimit, moralit, sjelljes etj. Këtë e zgjodhi vetë Krijuesi i gjithësisë me dëshirën e Tij absolute, sipas parametrave hyjnorë dhe jo njerëzorë. E ngarkoi me një përgjegjësi të madhe dhe të vështirë, në një kohë që njerëzia ishte zhytur në rrugën e besimit të gabuar, në adhurimin e statujëve dhe fenomeneve natyrore, në udhën e prishjes së etikës dhe të veprave destruktive antinjerëzore. Ai gjeti para vetes sundimtarë që krijesat e Zotit xh.sh. i kishin bërë shërbëtorë dhe skllëvër pa gëzuar asnjë të drejtë njerëzore. Erdhi në një kohë që morali kishte rënë përtokë, luftërat dhe konfliktet ishin përhapur tej mase, i forti mundte të dobëtin, i pasuri shfytëzonte të varfërin, pra me një fjalë nuk ekzistonte asgjë njerëzore dhe asnjë ndjenjë shpirtërore. Kështu me shembullin e tij të lartë dhe të përsosur arriti t'i kthejë njerëzimit rrugën e vërtetë Islame, rrugën e përparimit dhe të shpëtimit. Pra, le të marrim shembullin e këtij reformatori të madh, të ecim sipas rrugës së tij në ibadet, i cili arriti gradën më të lartë duke mos lënë anash aktivitetin e jetës së përditshme, siç është thirrja në Islam, lufta në rrugën

e Allahut, iniciativa e tij për të vendosur themelet e shtetit Islam etj. Gjithashtu, ne si myslimanë dhe ithtarë të tij, le të ndjekim shembullin më të lartë të modestisë, e cila ka qenë e ngulitur thellë në ndërgjegjen e këtij personaliteti të dalluar. Le të ndjekim shembullin e tij në mëshirë dhe butësi, me të cilat kishte arritur shkallën më të lartë pas fitores mbi kundërshtarët dhe armiqtë e Islamit. Allahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Dhe ty (Muhamed) nuk të kemi dërguar vetëm mëshirë për të gjitha botrat”.** Shembulli i trimërisë së tij në kohën e injorancës dhe në kohën e Islamit na obligon që të mos i frikësohemi mizorit, diktatorit, arrogantit, të mos i frikësohemi armikut të Allahut, për derisa jemi të udhëzuar dhe të kapur pas Islamit. Allahu (xh.sh.) thotë në Kur'an: **“Nëse ndihmoni (përkrasht) fenë Islame, (Allahu) ju ndihmon juve”.** Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi a.s., ishte shembulli i qëndrueshmërisë ndaj dispozitave dhe principeve Islame. Këtë veti e mbajti gjatë gjithë jetës pa u mashtruar nga bukuritë dhe premtimet e kësaj bote materiale. Ai i qëndroi Islamit duke u ballafaquar me vështirësi e kërcënime nga më të ndryshmet deri në momentet që ai kaloi tek mëshira e Zotit xh.sh. Ai ishte shembulli në të gjitha çështjet e moralit Islam, si: në sinqeritet, në kryerjen e amanetit, në komunikim me njerëzit, në durim, pastërti, mbajtjen e fjalës, bujari, zemërgjerësi etj. Këto cilësi dhe veti janë të përmbledhura tërësisht në një ajet të Kur'anit famëlartë: **“Vërtetë, ti je në një gradë të lartë të moralit”.**

Kjo ditë madhështore festohet në të gjitha vendet e botës myslimane në mënyra të ndryshme, si: me mbajtje bisedash dhe kumtesash rreth jetës së ndritshme të Muhamedit (a.s.), me organizime tubimesh e takimesh duke trajtuar probleme rreth personalitetit të të dërguarit të Zotit (xh.sh.), këndime ajetesh të Kur'anit të shenjtë, ilahi dhe këndime me melodi të jetës së Pejgamberit a.s., ku secili popull e këndon në gjuhën e vet. Sipas veprës “Mevludet në gjuhën shqipe” të autorëve Faik Luli dhe Islam Dizdari ne shqiptarët kemi mbi 20 mevlude origjinale dhe përktime të hartuar nga autorë të ndryshëm kudo që jetojnë e banojnë shqiptarë. Mevludin e këndojnë ata që e kanë zërin e bukur dhe melodioz.

Ndërkaq duhet të përmendim se, ndonëse festimi dhe përkujtimi i këtij përvjetori, i kësaj ngjarjeje të shënuar për të gjithë myslimanët nuk është lënë me gojë dhe me thënie nga vetë Pejgamberi ynë (a.s.), ky eveniment mbeti një vepër e mirë dhe e dobishme për mbarë besimtarët myslimanë. Në lidhje me këtë në një hadith që e transmeton Ibn Mes'ud thuhet: *“Atë që myslimanët e shohin se është vepër e mirë, që duhet të bëhet, do të konsiderohet e mirë edhe tek Allahu, edhe atë që myslimanët e shohin të keqe, që nuk duhet të bëhet, edhe tek Allahu konsiderohet e*

*keqe*”. Duke u nisur nga ky hadith dhe të tjerë si ky themi se festimi i mevludit është një vepër e mirë, që sjell shumë dobi dhe efekte të mira për besimtarët Islam. Veçanërisht në kohën e sotme duhet festuar mevludi për disa arsye kryesore:

Së pari: Myslimanët duhet të lexojnë dhe të shtojnë njohuritë rreth jetës dhe veprës së të dërguarit të Zotit, Muhamedit (a.s.).

Së dyti: Myslimanët duhet të marrin pjesë në aktivitete dhe takime të ndryshme fetare, në të cilat trajtohen tema të larmishme Islame.

Së treti: Duke festuar mevludin brenda normave të Sheriatit Islam me mbajtje ligjëratash, biseda, lexime të ajeteve të Kur’anit, recitime dhe këndime nga pjesë të mevludit, ku ka një pjesëmarrje tepër të madhe nga ana e myslimanëve, është arritur që këta të vijnë edhe në evenimente dhe raste të tjera të rëndësishme, gjithashtu është arritur që të frekuentojnë edhe xhamitë për të kryer adhurimet obliguese, si p.sh. faljen e ditës së xhuma, faljet e ditës etj.

Një pjesë e konsiderueshme besimtarësh islamë nuk dinë rreth jetës, figurës dhe moralit të Pejgamberit Muhamed (a.s.) në një kohë që, po t’i pyesësh se kush janë udhëheqësit më të njohur të botës moderne, se cilët janë artistët më të njohur, se cilët janë sportistët më të mirë të botës, pa mëdyshje do të përgjigjen menjëherë saktë dhe në mënyrë perfekte. Por, kur i drejtohem se cili është emri i plotë i Pejgamberit të Islamit dhe çka dinë rreth tij, nuk dinë të përgjigjen dhe çka është më keq, nuk dinë të japin përgjigje edhe rreth vendit ku ndodhet Qabja. Pra, është jo e hijshme që myslimani të mos dijë rreth Pejgamberit të tij, rreth Islamit dhe Kur’anit. Këtë do ta argumentojmë me një rast konkret që kemi vënë re pikërisht gjatë këtij muaji në një konkurs televiziv në televizionin privat “Vizion Plus”. Për pyetjen se ku ndodhet Medinja që është një nga tre vendet e shenjta të myslimanëve, në kompjuter u paraqiten tre alternativa: Arabi Saudite, Irak dhe Siri. Në vend që të përgjigjej se Medinja ndodhet në Arabinë Saudite, u tha në Irak. Pra, kjo është gjendja dhe e vërteta e disa myslimanëve këtu në Shqipëri, që nuk dinë pothuajse aspak rreth fesë së tyre, që Zoti (xh.sh.) i ka krenuar dhe dalluar nga popujt e besimet e tjera.

Në një ajet Kur’anor thuhet: **“Ne nuk të dërguam ty ndryshe, vetëm se për të gjithë njerëzit, përgëzues dhe qortues, por shumica e njerëzve nuk e dinë”**. Duke parë se një pjesë

e njerëzve nuk dinë rreth Islamit, atëherë është detyrë e dijetarëve dhe thirrësve Islam që t’i mësojnë këta njerëz për fenë e tyre. Festimet madhështore, mes tyre edhe mevludi sherif kanë dobinë e këshillimit në të mirë. Këtë e shohim në një verset të Kur’anit famëlartë: **“Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën dobi”**. Jo vetëm kaq, por festimi i mevludit është shprehje dashurie e respekti ndaj Pejgamberit tonë a.s. dhe kjo është detyrë e çdo myslimani e myslimaneje, e cila duhet t’i paraprijë dashurisë për pasurinë, për fisin, shtëpinë, fëmijën, tregëtinë etj. Këtë e vërteton ajeti 24 i sures Et-Tevbeh: **“Thuaj, (o i dërguar) në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshorti juaj, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregëtia që frikësoheni se do t’u dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.”**

Mevludi i cili duhet të festohet në kuadër të Islamit, pa e kthyer atë në mjet biznesi dhe përfitimi material konsiderohet vepër e mirë dhe padyshim që veprën e mirë Allahu (xh.sh.) e shpërblen. Jo vetëm kaq, por përveç festimit të këtij përvjetori është e këshillueshme që të agjërojmë këtë ditë, sepse, kur Muhamedi a.s. është pyetur për agjërimin e ditës së hënë, ai është përgjigjur: *“Në atë ditë kam lindur dhe në atë ditë ka zbritur Kur’ani”*. (Transmeton Muslimi).

Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), përkujtohet jo vetëm në mevlude, por përmendet, respektohet dhe ecet sipas traditës dhe syneve të tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Këtë meritë ja ka dhënë vetë Allahu (xh.sh.) të cilin, përveçse e ka sjellë si Pejgamber i Zotit në këtë jetë materiale, e ka pajisur edhe me cilësinë e një burri të madh, të një strategu të shquar e të rrallë, një shembull të shkëlqyer në të gjitha lëmitë e kësaj jete të përkohshme. Çdo mysliman duhet të ecë sipas shembullit, udhëzimeve dhe këshillave të tij, sepse kështu do të fitojmë mëshirën e Zotit të gjithësisë: **“Thuaj, nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje, që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që fal shumë, mëshiron shumë”**. [Ali Imran: 31].

Arben Halluni



# SI E ADHURONIN ALLAHUN DIJETARËT DHE EVLIJATË?



Qëllimi ynë këtu, natyrisht, nuk është të përshkruajmë tërë jetën e dijetarëve që e kanë kaluar në adhurim, por për të shpjeguar lidhjen e tyre me Allahun, dëshirojmë të japim një ide rreth disa llojeve të adhurimit (veçanërisht adhurimit me namaz) me disa shembuj:

### Imam A'dham ishte shumë i dhënë pas namazit

Imam A'dham Ebu Hanife, themeluesi i medhhebit Hanefi, ishte një person i kënaqur, bujar, i besueshëm, i cili ishte i dhënë pas adhurimit. Ai ka vepruar gjithmonë drejt si në marrëdhëniet e tij tregtare ashtu edhe në ato njerëzore dhe ka fituar vlerësimin e të gjithëve. Ai ishte jashtëzakonisht i ndjeshëm që asgjë e paligjshme apo e dyshimtë të mos ndërhynte në fitimet e tij. Kur mësoi se partneri i tij, Hafs bin Abdurrahman, kishte shitur pa dashje një pëlhurë me defekt me një çmim normal, ai i dha të gjitha paratë nxënëseve që fitoi nga ai mall.

Pasi llogarit të ardhurat e tij vjetore, ai plotëson nevojat e dijetarëve dhe studentëve që e rrethojnë dhe u thotë: "Merreni këtë dhe shpenzoni ku të keni nevojë. Falënderojë vetëm Allahun për veprën time te mire. Sepse kjo pasuri që të kam dhënë nuk është e imja; Për pjesën tuaj, Allahu jua ka dërguar me dorën time." do të thoshte ai. Gjatë dhënies, ai nuk kërkoi mirënjohje, thjeshtë kujtonte se ishte si një shpërndarës/ofruer dhe drejtoi lavdërime dhe falënderime për Allahun.

Ebu Hanife ishte një person që e donte shumë adhurimin e tij dhe veçanërisht namazin. Si shumë të tjerë, ai u krahasua me një shtyllë për shkak të lutjeve të tij të shumta dhe qëndrimit të tij të gjatë. Kasim Ibn Ma'n e gjeti atë një natë duke qëndruar në namaz dhe ishte dëshmitarë se si ajetin, *"Ndërkaq afati i tyre është Dita e kijametit, por Dita e kijametit është e rëndë dhe e hidhur."* (Kamer, 54/46) e përsëriti me lot deri në mëngjes.<sup>1</sup>

Mis'ar Ibn Kudam pa se Ebu Hanife e kaloi tërë ditën - përveç faljes së namazit të rregullta - duke diskutuar rreth diturisë, ai mendoi me vete: "Pas gjithë kësaj lodhjeje, kur gjen kohë për t'u falur natën?" U fal namazi i jacisë dhe të gjithë po pushonin kur Imam Adham shkoi në xhami. Ai qëndroi i drejtë, si një shtyllë dhe e kaloi gjithë natën në namaz. Ebu Hanife hyri në shtëpinë e tij gjatë orëve kur njerëzit u zgjuan dhe filluan të lëvizin ngadalë. Pasi rinovoi abdesin dhe rregulloi flokët dhe mjekrën, u kthye në xhami për të falur namazin e sabahut. Pas faljes së namazit, ai u ul për të diskutuar mbi shkencën, siç bëri dje dhe e kaloi edhe atë ditë kështu.

Duke parë të gjitha këto, Misari mendoi: "Ndoshta ky program është diçka me të cilën Imami është mësuar këto ditë", por shpejt e kuptoi se Imami gjithmonë e përdorte kohën e tij në këtë mënyrë.<sup>2</sup>

1. Zehebi, Sijeru Al'âmi'n-Nubelâ 6/399.

2. Zehebi, Sijeru Al'âmi'n-Nubelâ 7/448; Ebû Nuajm,

Hammad b. Selame jetonte me vetëdijen se do të vdiste në çdo moment

Pa dyshim, Hammad b. Seleme është një nga gradët më të ngritura nga bota jonë e shkencës. Abdurrahman Ibn Mehdi tha për vete: "Nëse i thua Hamadit: "Do të vdesësh nesër", ai nuk do të mund të shtojë asgjë më shumë në veprat që ka bërë deri më tani" tha ai. Me fjalë të tjera, ai e përdori kohën aq mirë dhe tregoi një robëri të tillë, sa që nëse do të vdiste nesër, nuk kishte asgjë për të vënë si plus. Sepse ajo që ai bërë deri atë ditë nuk ishte gjë tjetër veçse veprime të një personi që vepronte me vetëdijen se do të vdiste të nesërmen.

Musa Ibn Ismaili tha: "Nëse ju them se nuk e kam parë kurrë Hamadin duke buzëqeshur, nuk do të ishte ekzagjerim. Sepse ai e kalonte kohën e tij ose duke transmetuar hadithe, duke lexuar Kur'an, duke tërhequr tespih ose duke u falur. Në këtë mënyrë e ndante kohën." Kështu tha ai dhe se e ka shfrytëzuar shumë mirë kohën.<sup>3</sup>

Ky njeri, i cili është nipi i Aliut, për shkak të bukurisë dhe bollëkut të adhurimit të tij, u quajt "Zejnulâbidin", domethënë "stoli dhe krenaria e adhuruesve". Dy gjunjët ishin kallo si gjunjët e deveve. Ai po qante kur vdiq. Djali i tij tha: "Çfarë është ajo që të bën të qash, baba? Ju e keni jetuar jetën tuaj në maksimum dhe e keni stolisur me adhurimin tuaj. Pse jeni të shqetësuar?" kur pyeti: "Fëmija ime! Në Ditën e Gjykimit nuk do të ketë as melaqe mukarreb e as pejamberë. Do të takohemi me Allahun e Madhëruar. Atë ditë, nëse dëshiron, fal, nëse dëshiron, dënon." Ai tregoi se ishte i shqetësuar për fatin e tij.<sup>4</sup>

Një person i cili po falej i përlotur nën Ullukun e artë<sup>5</sup> në zonën e Hixhrit, që konsiderohet si brendësia e Qabesë, tërhoqi vëmendjen e Tavus Ibn Kejsan. Kur e mbaroi namazin, iu afrua dhe kuptoi se personi ishte Zejnulâbidin. Ai iu drejtua me ndjeshmëri adhurimit të tij vete përçmues si vijon: "Shpresoj që të jeni të sigurt në akhoret për tre gjëra. Së pari; ju jeni nipi i të Dërguarit të Allahut. Pastaj; Gjyshi juaj Resulullahu do të ndërmjetësojë për ju. E treta; Mëshira e Zotit (Pse e mundon veten sikur je i mjerë kur ke garanci kaq të forta?)."

Imami i madh iu përgjigj kështu kësaj pyetjeje: "O Tavus! Të qenit nip i të Dërguarit të Allahut nuk më bën Hiljetu'l-Evljâ 6/250.

3. Ibnu'l-Xhevzi, Sifatu's- Safve 4/145-146.

4. Shih. Suren Mu'minûn, 23/101.

5. Ulluku i artë (turq. Altinoluk) ishte vendosur në murin veriperëndimor të Qabesë midis qosheve të quajtura Rukn Shamî dhe Rukn Garbî dhe në mes të këtij muri. Kështu, uji i shiut i grumbulluar në çatinë e Qabesë derdhet në Hixhër përballë këtij muri. Në fund të ullukut, ekziston një projeksion i quajtur lihjetu'l-mizâb (mjekra e ulluqit) ose zaknu'l-mizâb (nofulla e ulluqit), e cila ndoshta është bërë për të lejuar që uji të rrjedhë pak poshtë (Shën. i përkthyesit).

të sigurt nga dënimi i Allahut. Sepse Allahu i Madhëruar thotë: Kur t'i fryhet borisë, në atë ditë nuk do t'u bëjë dobi as dashuria e të afërmeve mes tyre dhe as nuk do të kujtohet të pyesë për gjendjen e dikujt tjetër.

Kur gjyshi im vjen në ndërmjetësimin e të Dërguarit të Allahut, ajeti i mëposhtëm më pengon të besoj tek ai: "... Ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cillin është i kënaqur..." (Enbija, 28/21) Sa i përket mëshirës së Allahut, nuk jam i sigurt për veten time për shkak të ajetit vijues: "...Vërtet, mëshira e Allahut është afër njerëzve të mirë."<sup>6</sup> Nuk jam i sigurt nëse jam prej atyre që përshkruhen si dashamirës në këtë ajet.<sup>7</sup>

### **Fudejl Ibn Ijad ishte i zënë me adhurim deri në mëngjes**

Fudejl Ibn Ijad ia kishte kushtuar jetën namazit dhe ishte i apasionuar pas namazit. Njerëzit e përshkruanin atë si një person të mërzitur, meditues, i cili e bëri pëlqimin hyjnor bazë në të gjitha veprat e tij. Duke thënë: "Jam rritur me njerëz që shtrihen në shtrat dhe kanë turp të kalojnë kohët e errëta të natës duke fjetur", Fudejli ngrihet papritmas ndërsa ishte shtrirë në anën e tij në shtrat dhe thotë me vete: "*Nuk të shkon ty të flesh! Çohu dhe përfito nga ahireti.*"<sup>8</sup>

Ai hidhte një rrogoz në cep të xhamisë dhe ndalonte për t'u falur në orët e para të natës. Kur e zinte gjumi, shtrihej dhe pushonte pak. Pasi zgjohej, e ripërtërinte abdesin dhe vazhdonte namazin. Në këtë mënyrë ai do të ishte i zënë me adhurim deri në mëngjes.<sup>9</sup>

### **Sufjan eth-Thevri ishte një i dashuruar pas ditorisë dhe adhurimit**

Kushdo që kërkon këshilla: "Puno për këtë botë aq sa të rrih në këtu. Puno për ahiret aq sa do të rrih atje." Sufjan eth-Thevri shkroi në një copë letër: "Mos harroni se do të llogariteni në praninë e të Madhërishmit Allahut" dhe ai e nxirrte dhe e lexonte këtë për çdo ditë.

6. Abdulhâlim Mahmud, Sejjiduna Zejnu'l-âbidin fq. 31-32 [Daru'l-Maarif, Kajro, 2. bot, 1999].

7. Ibnu'l-Xhevzi, Sifatu's- Safve 2/241

8. Ibnu'l-Xhevzi, Sifatu's- Safve 2/238

9. Ebû Nuajm, Hiljetu'l-Evljâ 7/51; Zehebî, Sijeru A'lâmi'n-Nubelâ 7/258.

Ai ishte mysafir i Ibn Mehdiut një natë. Ai filloi të qante. "Përse po qan" kur u pyet: "Kam frikë të mos bëhem jobesimtar". Ai ishte një person kaq i ndjeshëm. Një herë tjetër, arsyen e lotëve që derdhi, ai e shpjegoi duke thënë: "Kam shumë frikë të jem i shkruar në Ummu l-Kitab, pra në gjykimin e Allahut si shaki (i frustruar përjetësisht, i cili humbet në ahiret)".<sup>10</sup>

Ai ishte një i dashuruar i shkencës dhe i adhurimit. Ai ia kushtonte kohën e tij të çmuar ose lartësimit dhe diskutimit të hadithit ose namazit. Kur nuk merrej me hadithe, falej mes drekës dhe ikindisë, akshamit dhe jacisë, dhe nëse dëgjonte se në një vend kishte një diskutim hadithi, shkante menjëherë.<sup>11</sup> Natën e kalonte duke u falur dhe spërkatte me ujë fytyrën e tij dhe të përpiquej të zgjohej. I zgjonte edhe të rinjtë dhe u thoshte: "Të rinj, ngrihuni! Përderisa keni një bekim si rinia, ringjallni netët tuaja me namaz."<sup>12</sup>

Me këtë përkujtim ka dashur t'u thotë të rinjve: Nesër, kur të jeni plakur, nuk do të mund të ngriheni për të adhuruar dhe të adhuroni sa të doni, edhe sikur të dëshironit. Pra, vlerësojeni rininë tuaj dhe shfrytëzojeni këtë periudhë aktive në rrugën e Allahut.

Duke u falur qante dhe frikësohej, e në veçanti i përkushtohej sexhdes. Ai e shihte Kur'anin të recituar në namaz si dhikrin më të vërtetshëm. Një herë, ai shkoi përpara për të prirë namazin e akshamit dhe filloi të lexojë Fatihanë duke thënë tekbir. Kur po lexonte "Ijjeke na'budu ve ijjeke nestein/Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë." ai nuk i mbante dot lotët. Ai priti pak. Pastaj ai mundi ta përfundonte Fatihanë duke përsëritur fillimin e sures.<sup>13</sup>

Abdurrahman Ibn Mehdi thoshte: "*Nuk mund ta dëgjoja Sufjanin duke lexuar Kur'an sepse ai qante shumë.*"<sup>14</sup>

**Përktheu: Haki Sahitaj**

10. Zehebî, Sijeru A'lâmi'n-Nubelâ 7/267.

11. Ibn Ebî Hatim, el-Xherh ve't- Ta'dil 1/96.

12. Ebû Nuajm, Hiljetu'l-Evljâ 7/17.

13. Zehebî, Sijeru A'lâmi'n-Nubelâ 7/277.

14. Suhreverdî, Avarif, 470.





# *Ftesë*

**PËR TË PËRMBUSHUR  
PARIMET KRYESORE TË  
ISLAMIT**

## **Profeti ynë e fton Xheririn, të besojë në Islam dhe të përmbushë detyrimet e fesë**

Xherir bin Abdullahu (radjiallahu anhu) tregon: “Profeti (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) më dërgoi lajm se donte që të shkoja pranë tij. Kur shkova, Ai më pyeti:

- “Për çfarë ke ardhur, o Xherir?”

- “O i Dërguari i Allahut! Unë kam ardhur këtu për të të thënë se dua të bëhem mysliman.”

Ai më hodhi në shpinë një rrobë dhe pastaj u kthye nga sahabët dhe u tha:

- “Kur t'ju vijë ndonjë prej parisë së njerëzve, qeraseni atë me gjënë më të mirë që ju gjendet.” Ndërkaq, pas pak çastesh, u drejtua nga unë dhe më tha:

- “Xherir, të ftoj që të dëshmosh se nuk ka zot tjetër pos Allahut, se unë jam i Dërguari i Allahut, si dhe të besosh tek Allahu, te Dita e Gjykimit dhe Kaderi, e t'i falësh të gjitha namazet e detyruara e ta japësh zekatin.”

Unë pranova menjëherë, duke i dhënë fjalën se do t'i bëja të gjitha ato që më tha. Pas atij çasti, sa herë që qëlloja të isha ballë për ballë me të Dërguarin e Allahut, ai më buzëqeshte.”

Porosia e Profetit tonë për Muadh bin Xhebelin në lidhje me këtë çështje

Ibni Abasi (radjiallahu anhu) tregon: “Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), kur e pati dërguar Muadh bin Xhebelin (radjiallahu anhu) si vali në Jemen, e pati urdhëruar me këto fjalë:

- “O Muadh! Ti po shkon pranë një populli ku të gjithë janë njerëz të librit. Kur të shkosh atje, ftoj njerëzit që të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër, veç Allahut, që meriton të adhurohet, si edhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Nëse ata i pranojnë të dyja këto dëshmi, duke t'u bindur, atëherë bëju të ditur se Allahu u ka urdhëruar robërve të Tij që të falin pesë namaze në ditë, çdo ditë, nga mëngjesi në mbrëmje. Nëse e pranojnë edhe këtë, atëherë thuaju edhe se Allahu ua ka shpallur detyrim, që një pjesë të pasurisë së tyre ta japin si zekat për më të varfrit. Nëse do të të binden edhe në këtë pikë, atëherë ngurro që të marrësh prej tyre më të mirat e mallrave të tyre! Frikësoju lutjes së njeriut që i është bërë një e padrejtë, sepse mes lutjes së njeriut që ka rënë pre e padrejtësisë dhe Allahut nuk ka asnjë pengesë.”

## **Profeti ynë i bën thirrje Hausheb Dhi-Zulejmit**

që të përmbushë detyrimet e caktuara prej Allahut Hausheb Dhi-Dhulejmit na rrëfen: “Kur Allahu i Madhërishtëm e nxori ngadhënjimtar Muhamedin (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), unë dërgova plot dyzet kalorës nën komandën e Abdi-Sherrit. Kur lajmësit e mi mbërritën në Medinë, bashkë me letren që unë

kisha dërguar për të Dërguarin e Allahut, Abdi-Sherrit thirri: “Kush është Muhamedi nga ju?”

- “Ky është.”, – më treguan me dorë.

- “Çfarë ke prurë ti? Nëse ajo që ti na ke prurë është diçka e mirë dhe e vërtetë, atëherë ne do të bindemi.”

- “Do të falni namazin, do të jepni zekatin, nuk do të derdhni gjak njeriu, do të urdhëroni për të mirë dhe do ta ndaloni kryerjen e së keqes.”, – tha.

- “Epo, qenkan të mrekullueshme këto mësimet që ti na ke sjellë! Zgjate dorën të të shprehim besëlidhjen.”

- “Po ty, si të quajnë?”, – e pyeti Profeti i profetëve (sal'lallahu alejhi ue sel'lem).

- “Abdi-Sherr!”, – u përgjigj ai.

- “Përkundrazi, ti duhet të quhesh Abdi-Hair.”, – tha i Dërguari i Allahut.

Ai që e transmeton këtë ndodhi thotë se ky njeri i besoi të Dërguarit të Allahut dhe i shprehu Atij besën e plotë. Profeti ynë i dërgoi Hauxheb bin Dhi-Dhulejmit përgjigje me të, edhe Haushebi besoi në Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”

Profeti ynë fton bashkësinë e Abdulkajsit, që të përmbushin detyrimet e caktuara prej Allahut (farzet)

Ibni Abasi (radjiallahu anhu) tregon: “Kur erdhën mëkëmbësit e drejtuar prej Abdulkajsit te Profeti ynë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ai u tha atyre:

- “Mirë se keni ardhur! Inshaallah, ju nuk do të pendoheni që keni ardhur deri këtu; nuk ka për t'ju ndodhur asgjë e keqe.”

- “O i Dërguari i Allahut, mes nesh dhe jush qëndron një grup idhujtarësh nga Mudari, ndaj vetëm gjatë muajve të ndaluar neve na jepet mundësia të vijmë tek ju. Prandaj edhe kemi ardhur, të na thuash ndonjë prej kumtesave të tua të bukura, që ne ta përmbushin, e të shkojmë në Xhenet, madje t'i ftojme edhe të tjerët drejt asaj mirësie.”

- “Katër janë gjërat që unë po ju urdhëroj, katër janë gjërat që po jua ndaloj. Katër të parat janë këto; të jeni të palëkundur në besimin se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, të falni namazin, të jepni zekatin, të agjëroni gjatë muajit të Ramazanit dhe të jepni një të pestën e fitimeve nga plaçka e luftës për të varfrit. Dhe katër gjërat që jua ndaloj janë; shtambat e përbëra nga kungulli i ujit, bardakët prej balte dhe enët e lyera me zift e katran dhe çanakun e bërë prej rrënjës së hurmës (enë të cilat jua ndaloj që t'i mbushni me shirën e rushit, apo të hurmave). Këto t'i mbani mend mirë dhe të mos i harroni, madje t'ua bëni edhe të tjerëve të ditura.”

**Shkëputur nga libri “Jeta e Sahabëve 1”  
M. Jusuf Kandehleui  
Botim i KMSH**

# Lexa...



Fjala ka bërthamë hyjnore, në brendësi, në përmbajtjen e saj.

Fjala ka bërthamë dashurie, prandaj fjalën duhet ta duam si vetë jetën, ta mbjellim, rritim e selitim, siç e meriton.

Fjala ka bërthamë diturie, ndaj duhet ta respektojmë e çmojmë shumë atë. Fjala respektohet e çmohet duke e shkruar e lexuar me kujdes, duke mësuar me këmbëngulje e durim nëpërmjet saj...

Shpallja e Librit të Shenjtë të fundit (Kur'anit Kerim) fillon me një fjalë të mrekullueshme, sa hyjnore, aq edhe njerëzore, tokësore me plot kuptim: "Ikre!", "Lexo!" Ky është urdhri suprem i parë i Zotit Fuqiptotë: "Lexo! Me emrin e Zotit tënd, që gjithçka krijoi, njeriun e krijoi nga një copë gjaku! Lexo! Zoti yt është më i madhi Bujar, që me anë të penës ia mësoi; ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte." (96:1-5)

Disa dijetarë, mendimtarë vizionarë, fjalën "Lexo!" e barazojnë me fjalën "Jeto!". Duhet të kenë të drejtë. Fjala-urdhër, këshillë, porosi, "Ikre!" mund të ketë kuptime të shumta në gjuhën tonë: Lexo, këndo, lëçit, kupto, mëso, zbato, përhap, recito, kumto, transmeto, mendo...

Njeriu i paralajmëruar është gjysmë i shpëtuar

Shpallja hyjnore dhe Profeti i fundit zbritën dhe erdhën si Paralajmërues. Fjala Hyjnore erdhi si Porosi Madhore, si këshillë dhe mirësi e madhe mbi këtë botë; erdhi si një bekim. Shpallja hyjnore së bashku me fjalët dhe veprat profetike janë mësimet të mëdha dhe paralajmërime kuptimplote për njeriun. Ato janë mirësia më e madhe për ne, sepse njeriu i paralajmëruar është gjysmë i shpëtuar. Derisa ne kemi mundësi të dallojmë nëpërmjet shembujve se ç'është e mirë e ç'është e keqe në jetë, dimë se ç'duhet të bëjmë për të qenë të dobishëm në jetë, për vete e për të tjerët, themi se na janë krijuar mundësi reale për të përmbushur qëllimin për të cilin jemi krijuar...

Opinionit i përgjithshëm për brezin e sotëm është se njerësit e këtij brezi lexojnë gjithnjë e më pak. Ky gjykim, ose më mirë të themi ky paragjykim, ka qenë manifestuar me shekuj nga brezi paraardhës për atë pasardhës. Shpresoj që ky opinion të mos jetë i vertetë. Por fakti se njeriu sa vjen e bëhet më kapriçioz, kryelartë e mendjemadh, nuk është shenjë e mirë. "Mendjemadhësia bën pjesë në tarbietet e Djallit; mendjemadhësia e krenaria janë pjesë të Djallit. Zoti nuk i do ato. Djalli u dëbua nga

Parajsa sepse ishte kryelartë e mendjemadh" (O. Pamuk)

Brezi i sotëm i ka gati të gjitha mjetet e nevojshme për të nxënë, për të edukuar veten e për të mësuar gjithçka me anë të leximit: librat, bibliotekat, arkivat, gazetatat e revistat, internetin, radio-televizionet, etj. Mjetet e informimit e komunikimit janë shtuar e përsosur. Njeriu sot shkruan e lexon në letër, por edhe në xham, në qelqet magjike, prej ku informohet e dituroret më lehtë e për një kohë gjithnjë e më të shkurtër. Por si dje, ashtu edhe sot e përgjithmonë do të shtrohet naryrshpëm pyetja: Me zhvillimin e gjithanshëm të teknologjisë, a është njeriu vërtet i shpëtuar, apo ndodh e kundërta?!

Puna në kandilin e jetës hedh vaj,

Dituria ndez flakën e saj!...

Burimi kryesor i fitimit të dijeve dhe diturive është leximi. Dituria është dritë për njeriun. Dituria së bashku me besimin e vërtetë dhe me durimin janë pasuria më e madhe për njeriun. Leximi, të studiuarit, fitimi i diturisë është një proces i shenjtë; sa më të ditur të jemi, aq më tepër i afrohem Zotit, më të dobishëm bëhemi, më të devotshëm. Jeta është shkollë dhe baza e shkollës është leximi.

-Lexo! që të mësosh Gjithësinë

Njeriu duhet ta njohë mirë Gjithësinë, botën që e rrethon. Duhet të nxërë shkencat ekzakte, shkencat natyrore, shkencat shoqërore... Me qindra degë të shkencave mësohen sot nëpër shkolla, dituritë janë copëtuar, thelluar e grimcuar si asnjëherë tjetër. Këto shkenca, së bashku me mësimet bazë që vijnë nga Libri i Shenjtë, baza e të gjitha diturive, nuk është e lehtë që të përvetësohen ashtu siç duhet. Duhet shumë vullnet, punë, durim e këmbëngulje, veti këto që duhet t'i ketë çdo besimtar i vërtetë. Mbi të gjitha duhet një Metodë nxëniesje sa më e përsosur...

-Lexo! që të njohësh vetveten ...

Njeriu duhet të përpiqet ta njohë sa më shumë dhe sa më mirë e më thellë vetveten. "Kush njeh vetveten ka njohur Zotin." (Hadith)

Dija s'ka fund, e vërteta s'ka mbarim.

Zoti na bekoftë me dashurinë për të lexuar Fjalën e Zotit, Dijet e Zotit, që të fitojmë mirësinë, bekimin, paqen dhe kënaqësinë e Tij, si në këtë jetë, ashtu edhe në tjetrën!

**Hysen Kobellari**

# Tregimet e Profetëve në Kuranin Famëlartë



## Edukimi moral i njeriut

Jeta e njeriut në këtë botë është një rrugëtim i gjatë që ndërtohet në një realitet kohor dhe vendor të caktuar. Ai është një qenie me dimensione që zgjaten përtej vetes së tij të cilat kanë një lidhje ekzistenciale me çdo aspekt të jetës në këtë botë. Një prej këtyre aspekteve dhe subjekteve njohëse të intelektit të tij është edhe e historia. Ajo përbën një dimension të rëndësishëm të kësaj jete me anë të së cilës ajo merr kuptim, që njeriu të arrijë të njohë realitetin e gjërave dhe ndërtojë jetën

e tij sipas një etike të caktuar.

Nëse historia është një dimension i rëndësishëm i jetës së njeriut, ajo përbën një tematikë të rëndësishme në Kuranin Famëlartë si kandili ndriçues i ekzistencës dhe udhërrëfyyesi i njeriut në këtë botë. Kështu një pjesë e rëndësishme e tij përbëhet nga tregimet e profetëve. Nëpërmjet tyre njeriu del nga kufijtë e së sotshmes për të bërë një udhëtim në të shkuarën e largët e për të soditur një nga burimet më të rëndësishme të dijes që është njohja e së historisë.



Tregimet e profetëve në Kuranin Famëlartë nuk kanë për qëllim tregimin e historisë së jetës së tyre në mënyrë kronologjike, ashtu sikurse nuk janë një mënyre për tu shkëputur nga realiteti dhe e tashmja. Ato shërbejnë si burim njohje për njeriun në lidhjen me jetën e tij në këtë botë. Kështu tregimet nga jeta e profetëve nuk tregohen në mënyrë kronologjike por të shkëputura në fragmente të caktuara që shpjegohen në pjesë të ndryshme të Kuranit Famëlartë. Nëpërmjet tyre vihen në pah problematika dhe çështje të caktuara të natyrës njerëzore dhe jepen mësimet morale për njeriun. Si rrjedhojë, këto tregime shërbejnë që njeriu të shikojë ekzistencën e tij në dritën e së kaluarës në mënyrë që të njohë më mirë realitetin e jetës dhe të edukojë vetveten për të përsosur moralin e tij.

Kurani është një libër që i drejtohet të gjithë fakulteteve të perceptimit të njeriut dhe dimensioneve të tij. Për rrjedhojë, perceptimi dhe të kuptuarit tij nuk mund të kufizohet vetëm në aspektin teorik, në ligjërime dhe rregulla të shkruara por njeriu ka nevojë për shembullin dhe përvojën që të arrijë të kuptojë realitetin e gjërave. Kështu tregimi i historive në Kuran nëpërmjet përvojave në të shkuarën përcjell urtësinë e brezave dhe mësimet të pazëvendësueshme që nuk mund të arrihen me anë të kultivimit të dijeve të caktuara të cilat do qytetërimi në të cilin jeton njeriu. Këto shembuj nga e kaluara i drejtohen imagjinatës, emocioneve dhe mendjes së njeriut – së njeriut duke evokuar te ai ndjenja dhe përjetime të ndryshme në bazë të natyrës së ngjarjeve dhe intelektit të njeriut si subjekt njohës. Si rrjedhojë ato shërbejnë për ta frymëzuar, edukuar dhe orientuar njeriun drejt së vërtetave të përjetshme dhe përvetësimit të moraleve të larta.

### **Një perspektivë për shkencën e historisë**

**“A nuk kanë udhëtuar nëpër botë e të shohin si kanë përfunduar ata para tyre?”**

(Kuran 30:9)

Ndërsa Kurani është fjala e Zotit që reflekton të Vërtetën, universi është ana tjetër e saj. Çdo gjë në ekzistencë i përgjigjet disa ligjeve me anë të cilave është ndërtuar dhe vazhdon të drejtohet në mënyrë përkryer jeta në këtë botë. Historia, si pjesë e jetës së njeriut dhe një subjekt njohës që bindet ligjeve metafizike që janë reflektim i cilësive të Zotit dhe Vullnetit të tij duke përfshirë edhe vullnetin e pjesshëm të njeriut dhe lirinë e tij për të zgjedhur. Ashtu sikurse citohet në ajetin e mësipërm Allahu na fton vazhdimisht të hulumtojmë dhe studiojmë në aspekte të ndryshme për historinë e popujve të mëparshëm për të njohur ligjet që kanë karakterizuar qenien e njeriut dhe shoqëritë njerëzore. Kështu tregimet e profetëve në Kuranin Famëlartë përbënin një frymëzim për të njohur historinë dhe një botëkuptim në lidhje me perceptimin e historisë dhe shkencave që merren me studimin e saj. Ajo përbënte

një subjekt njohës për kuptuar natyrën e shoqërisë, ligjet dhe motivet që karakterizojnë zhvillimin dhe ndryshimet e saj në gjendje të caktuara. Kështu ata arrinin të lexojnë në mënyrë të drejtë problematika të caktuara të shoqërisë në të tashmen për të marrë vendimet e duhura në të mirën e përgjithshme të shoqërisë.

Tregimet e Profetëve në Kuranin Famëlartë janë ngjarje që zhvillohen në kohë, vende, kultura apo realitete krejt të ndryshme. Por, pavarësisht transformimeve që pësojnë shoqëritë, njeriu dhe entitetet e tjera reflektojnë të njëjtat parime metafizike të cilat janë të përjetshme. Për rrjedhojë edhe pse zhvillohen në kontekste të ndryshme karakteret, ngjarjet, marrëdhënia nëpërmjet të mirës dhe së keqes janë të njëjta. Nëpërmjet kësaj kuptojmë që historia nuk është diçka që i përket së shkuarës, por është një realitet që në thelb është i njëjtë por përsëritet duke marrë formë sipas kontekstit, kulturës apo natyrës së shoqërisë në të cilën zhvillohet. Kështu njohja e historisë kthehet në një thesar të vyer për kuptuar ligjet dhe parimet që kanë karakterizuar shoqëritë njerëzore për të njohur ekzistencën tonë dhe për të kontribuar në ndërtimin dhe zhvillimin e shoqërive njerëzore në të gjitha aspektet dhe dimensionet e saj.

Tregimet e profetëve flasin për qytetërimi të lashta dhe gjurmët që ato kanë lënë deri në ditët e sotme që janë objekt i studimit për shkenca të ndryshme. Aty aludohet për emancipimin, zhvillimin, zbulimet dhe arritjet e mëdha të shoqërive të ndryshme në aspekte të ndryshme të jetës deri në rënia dhe shuarja e tyre. Nëpërmjet tyre tregohet se historia nuk ndjek një rrjedhë lineare ku njeriu zhvillohet nga jeta primitive drejt emancipimit dhe një të ardhmeje të ndritur qoftë ky interpretim në aspektin fetar apo laik. Por, historia ndjek një rrjedhë ciklike, ku çdo kohë ka zhvillimin dhe qytetërimin e saj duke ndjekur një rrjedhë sipas disa ligjeve të caktuara. Në këtë kuptim, mund të thuhet se historia nuk ndjek këtë cikël si rrjedhojë e një qasjeje deterministe kundrejt saj por për faktin se ajo përfshihet në Vullnetin Zotit dhe Dijen e tij të pafundmë e cila është përtej konceptit dhe perceptimit tonë në lidhje me kohën. Në anën tjetër, njeriu ka vullnetin e lirë për të vepruar dhe lidhja e tij e tij me Zotin dhe ligjet e tij në tokë kanë rol thelbësor në zhvillimin e ngjarjeve.

Në përfundim mund të themi se ashtu sikurse njeriu, jeta e tij dhe çdo ekzistence në univers, edhe historia e njerëzimit mbetet një libër i hapur nga Zoti për të lexuar dhe zbuluar kuptimin e ekzistencës tonë. Ajo thur të njëjtën melodi me njeriun ku tregohet edhe njëherë harmonia dhe madhështia e kësaj jete për të njohur më mirë Krijuesin e gjithësisë.

**Abdullah Bulku**

*Vlerësimi i diturisë sipas fesë*

# Blame

*"A mund t'i thotë mendja se trupat qiellorë dhe toka kanë vetveten? Kurrsesi, sepse njeriu nuk sheh asgjë në botë që të krijojë vetveten."<sup>1</sup>*

Dituria është mjeti që të çon në krijimin e një jete të qetë e të lumtur, të mbron nga pengesat e vështirësitë dhe është stolia më e bukur që hijeshon mendjen e shpirtin e njeriut. Ajo është arma më e fortë në këtë jetë tokësore dhe kapitali më i çmuar për jetën tjetër. Me diturinë te Zoti i Lartësuar fillon angazhimi hyjnor që ia dërgoi nëpërmjet engjëllit Xhibril Muhamedit a.s.. Ai i tha: "Lexo!" Përgjigja ishte: "Nuk di". Së fundi i tha: "Lexo, me emrin e Zotit tënd". Pra Allahu i Lartësuar e filloi edukimin e arsimimit, që do të thotë se Ai merret në vazhdimësi me edukatën e krijesave të Tij. Ai tregon qartazi se mëshira e Tij e pakufizuar është që të ndriçojë zemrat e njerëzve me dritën e diturisë, t'u mësojë atyre vlerën e madhe që ka shkrimi e leximi, sepse mungesa e tyre do të linte njerëzimin në errësirën

e paditurisë. Por tërheq vërejtjen se dituria nuk ka fund dhe prandaj Profeti a.s. është lutur: "Zoti im, më shto mua diturinë!" Në të vërtetë, Profeti a.s. ka qenë përmbledhësi i diturive të ardhura para tij dhe atyre që do të vijjnë më pas. Dituria duhet të jetë gjithëpërfshirëse, si fetare ashtu edhe shoqërore e shkencore, që t'i shërbejë njeriut në përmirësimin e kushteve materiale e shpirtërore. Profeti a.s. ka thënë: "Kërkimi i diturisë është detyrë e domosdoshme e me rëndësi për çdo burrë dhe grua". Pra kërkimi i diturisë i përket të dy gjinive së bashku, pa asnjë dallim, por deklaron në mënyrë shprehëse se burrat dhe gratë myslimane, përgjithësisht duhet të jenë të ditur. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Nuk janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë".

Feja islame i kushton një vëmendje të veçantë gruas, pajisjes me dituri dhe edukimit të saj të shëndoshë, sepse ajo konsiderohet si edukatorja e të gjithë njerëzimit.

Sot, edhe pse jetojmë në shekullin e shkencës dhe diturisë, teknologjisë më të avancuar, qenia njerëzore

1. H. I. Dalliu, Ajka e kuptimeve të Kurani Qerimit, f. 159.

mbetet përpara sekreteve që mbart universi. Mendja e njeriut përpara fenomeneve të natyrës ka bërë hapa të rëndësishëm për t'u futur në të fshehtat e tyre. Por këto nuk janë veçse argumente që do t'i shërbejnë njeriut për të njohur Krijuesin apo Ligjvënësin e tij. Pra, duhet përdorur logjika e shëndoshë duke besuar se të gjitha të fshehtat që zbulohen janë krijuar nga Zoti i lartësuar, i Cili është i gjithëditur dhe i gjithëfuqishëm, pa fillim dhe pa fund. Një nga atributet e Allahut është dituria. Në Kur'an thuhet: "Ai është Allahu përveç të cilit nuk ka zot tjetër. Ai e di të fshehtën, edhe të dobishmen. Ai është mëshiruesi, bamirësi."<sup>2</sup>

Si ka mundësi njeriu të jetë mosmirënjohës kur i përdor disa shkenca antifetare si teoria e Darwinit që i merr si të vërteta dhe mohon Zotin e tij? Nuk mundet në asnjë mënyrë që njeriu të zgjidhë gjithë çështjet që përjeton në natyrë nëpërmjet argumenteve shkencore. A kujton ai se është krejtësisht i përsosur? Jo, ai e ka pronarin e pazëvendësueshëm, që nuk bën ortakëri me askënd në punën e Tij. Sot shkenca është tronditur nga të vërtetat e padiskutueshme që ka sjellë Kur'ani dhe të vërtetat e tij po dalin në shesh dhe po i nxjerrin studiuesit e rinj. Në Kur'an thuhet: "Çelësat e fshehtësive janë vetëm në dorën e Tij. Fshehtësinë nuk e di tjetërkush veç Tij. Ai e di çka ka në tokë e në dete. Jashtë dijes së Tij edhe një gjethë s'mund të bjerë dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë e të thatë që s'është shënuar në librin e hapur."<sup>3</sup>

Në këtë dritë duhet të shohim shkencat e ligjet e natyrës dhe krijesat në tokë e dete. Mbi këtë bazë duhet të ndërtojmë vëzhgimin e botës së gjallë, të bëjmë eksperimente dhe të vërtetojmë se asgjë nuk krijohet në mënyrë të rastësishme, qoftë edhe instinkti i kafshëve. Krijimi i të gjitha gjallesave është projektuar me ligje të sakta si për botën bimore ashtu edhe shtazore, për të ruajtur trashëgiminë e tyre. Në këtë fushë bëhen eksperimente, por asgjë nuk krijohet pa pasur qelizën origjinale. Le të marrim iniciativën dhe të krijojmë jetë të gjallë. Janë përpjekur, por nuk e arrijnë dot. Ligjet e Allahut për krijimin e jetës së gjallë, nuk mund të eksperimentohen. Këtu kemi të bëjmë me shpirtin që nuk është lëndor dhe s'mund të eksperimentohet. Shprehja e popullit thotë për njeriun që vdes: "I doli shpirti". Pra, nuk mundet që çështjet fetare të zgjidhen me metoda shkencore, por duhet t'i nënshtrohen diturisë dhe fuqisë absolute që e solli vetë njeriun në një organizëm të përsosur, çdo organ në vendin e duhur, në harmoni me njëri-tjetrin dhe të gjithë së bashku përbëjnë unitetin apo "unin njeri". Ky mbasi i fitoi këto nuk tregohet mirënjohës, falënderues dhe adhures ndaj Tij. Njeriut iu dhurua mendja për të fituar dituri dhe me anë të kësaj është i detyruar të vërtetojë Krijuesin e vërtetë. Feja nuk është produkt i vetë njeriut, por Krijuesi për të ruajtur të pastër krijesën e Tij dërgoi mesazhe hyjnore nëpërmjet të dërguarve të Tij. Njeriun e ka shoqëruar feja që nga origjina e deri më sot. Ai s'mund

2. Hashr, 22.

3. En'am, 59.

të ndryshojë rrjedhën e jetës, të kthejë pleqërinë në moshën e rinisë, apo të kthejë të vdekurit në jetë. Ku është kompetenca e shkencës? Pse shkencëtari apo mjeku nuk mbron veten e tij? Pra është feja, besimi në Zotin që i hap dritat shkencës dhe të gjithë njerëzit nën këtë moto të jetojnë të qetë e në harmoni me njëri-tjetrin.

Njeriu gjatë shekujve ka përjetuar luftëra shkatërrimtare dhe vetë ka prodhuar armët më të përsosura për të asgjësuar veten. Pra një armiqësi e tmerrshme vetëm për interesa materiale. Në këtë mënyrë shkencëtarët nuk kanë bërë përpjekje lidhur me formën e jetës së individit e shoqërisë. Për shkencëtarët nuk ka pasur as nuk ka vlera fakti që jeta jetohej kështu ose ashtu, që njerëzit të jetojnë të qetë e të lumtur. Njerëzit po sillen si ujqër ndaj njëri-tjetrit, krimet kanë arritur deri brenda familjes, gjë që tregon një ftohtësi të jashtëzakonshme. Po hidhen bomba e dinamit që nuk kursejnë as nënat e fëmijët e vegjël. Ka një kontradiktë të madhe sot brenda vetes së njeriut që është shkencëtar apo mjek. Është i njëjti njeri, nga njëra anë përpiket të shpëtojë jetë njerëzish, nga ana tjetër angazhohet për të prodhuar helme për ta mbytur atë. Me bomba të tilla kanë humbur miliona jetë njerëzish. Këtë e bën mungesa e fesë dhe e moralit fetar. Shkenca e pabazuar në miratimin e Krijuesit, Zotit të lartësuar, i sjell shkatërrime në tokë njerëzimit. Për të këtë arsye Allahu i madhërishtëm mesazhin e parë hyjnor e dërgoi në urdhrin "Lexo!". Ky urdher i është dhënë të dërguarit të Tij, Muhamedit a.s. bashkë me emrin e Tij: "Lexo, në emër të Zotit tënd!". Të mësosh dituri pa emrin e Krijuesit, do të thotë të mos e njohësh Atë. Atëherë prit ndëshkimin e tij. Prandaj Allahu i lartësuar u drejtohet mirënjohësve dhe atyre që u besojnë shkencave e u thotë: "Thuaj: "Sikur Allahu të na zgjaste natën deri në kiamet, cili zot tjetër do të mund të na sillte dritë? A nuk e kuptoni? Thuaj: "Sikur Allahu të na zgjaste ditën deri në kiamet, cili zot tjetër do të mund të na sillte natën që të çlodheshit? Akoma nuk doni të shihni të vërtetën.""

Njeriu me logjikë e arsye duhet t'i thërrasë ndërgjegjes së tij, të besojë Zotin e lartësuar, sepse këtu, në këtë botë, nuk mbaron çdo gjë për të. Kjo është botë provizore e tranzitore për të kaluar në botën tjetër në të cilën njeriu do të përgjigjet përpara Krijuesit për veprimtarinë e tij. Do të jetë përballë gjykatësit, fuqia e të Cilit është e pashembullt, që çdo send e ka krijuar nga hiçi apo asgjëja, e bëri të mirëqenë për njeriun, që është krijesa më e lartë dhe sundues në këtë botë me dijen e tij. Por pa dyshim, ka krijuar edhe një botë tjetër, të amshuar, të cilën mendja e njeriut nuk arrin ta konceptojë, por logjika e tij duhet ta provojë se ai vend nuk ka mbarim dhe këtu do të përjetojë shpërblimin ose dënimin për veprat e kryera. Prandaj secili duhet të kthehet me vetëdije në Islam e të dëshmojë: "S'ka zot tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Tij".

# Lindja e Profetit (a.s.)



Studimi e kërkesa, si dihet, po vazhdojnë pa prerë për të gjetur djepin e parë të përparimit njerëzor. Me fjalë të tjera: vallë ku filloi ky përparim, mbresat e të cilit arrijnë deri te qindvjetëshi ynë. Ky studim e kjo kërkesë, për një kohë të gjatë, pohonte se Egjipti ishte djepi i parë i përparimit për 6000 vjet me radhë dhe se më përpara kësaj kohe këthehemi në kohëra prehistoike që zbulimi i tyre, simbas methodës shkencore të vërtetë, është i vështirë. Faktet historike të historisë të afërme na vërtetojnë se dijetarët e Antikitetit kanë gërmuar e kërkuar dhe po vazhdojnë të gërmojnë e të kërkojnë në Irak (Mesopotamie) dhe në Syrie duke shpresuar të kuptojnë e të gjejnë rrënjët e përparimit Assyerin dhe Finicien dhe duke dashur të vërtetojnë epokën te e cila zënë fill a më mirë këthehen këto dy përparime: a është një epokë që parakalon epokën e përparimit Egjiptian Faraonik apo është pasardhës i këtij përparimi i influencuar prej tij? Çdo gjë që ka për të nxjerrë në shesh kërkimi i dijetarëve t'Antikitetit në këtë anë të historisë, nuk do të ndërrojë asgjë prej së vërtetës mbasi kërkimi n'Antikitet e Çinës dhe të Lindjes së Largët nuk ka zbuluar ende diçka që t'i kundërshtoj. Kjo e vërtetë është gjithnjë se djepi i përparimit të njeriut të parë a të lashtë, qoftë Egjipti, qoftë Fenicia ose Assyria, ishte i puqun me brigjet e detit Mesdhetar dhe ato të Detit të Kuq, shtu edhe se Egjipti ishte qendra më e fortë prej së cilës rrodhi rryma e përparimit të parë, një herë për në Greqi, pastaj edhe për në Romë. Gjithashtu duhet të përmendim se përparimi botëror në këtë qindvjetësh, në të cilin jetojmë, vazhdon të ketë lidhje të ngushtë e marrëdhënie të fortë me atë përparim të parë dhe se çdo gjë që ka të bëjë me historinë e përparimit n'ato vende dhe që e ka zbuluar kërkimi në Lindjen e Largët nuk pat lënë ndonjë vragë të dukshme në ndonjë kohë n'orientimin e përparimevet: Faraonik, Assyrian dhe Grek. Po, nuk e ndryshoi drejtimin e përparimevet në fjalë as edhe evolusionin e tyre për deri sa këto qenë ndërlidhur e patën ardhur në marrëdhënie me përparimin islamik, i cili la mbresë ndër ta; këta u-influencuanë aq shumë saqë, në qytetërimin njerëzor qëi shtrohet sot njerëzija, një pjesë e madhe e këtij qytetërimi, ndofta më e madhja dhe më themeloria, meriton të quhet islamike.

Dihet fare mirë prej gjithëkujt se lulëzimi i qytetërimave të sipërpërmendura, pat arritur shkallën më të mrekulluar n'Egjipt, Assyrie dhe Greqi aqë sa edhe sot është objekt i habisë dhe i admirimit të botës. Lulëzim ky në diturie (shkencë), industrie, bujqësi, tregëtie

si edhe n'artin luftarak. Porse, rrënja a gurra prej të cilës këto qytetërima burojshin dhe fuqizoheshin ishte në çdo periudhë apo gurrë këjo që vërtitej nga një anë ndërmjet trinitetit të vjetër egjiptian, i cili përfytyrohej n'Osiris, Isis dhe Horus që i bënte shenjë unjisimit të jetës në rrënimin dhe përtëritjen e saj, në immortalitetin e pakëputur që kapërcente prej prindërve të bijtë dhe nga ana tjetër ndërmjet t'idhujtarisë greke që përfytyrohej në të Vërtetë (El Hakk), në të mirën (el hajr) dhe në të bukurën (el xhemal), përfytyrim ky i marrur prej shfaqëjeve të qënmerisë që i shtrohen ndjenjës. Përsëri ndryshoi pastaj aq shumë shkallëvet (Dunëja el meratibi) në qindvjetorin e ndryshëm të dekadencës dhe t'errësirës. Porse, rrënja apo gurra mbeti gjithnjë themeli i këtyre përparimevet që trajtuan ecjen e botës, rrënjë këjo e cila ka lënë edhe një mbresë të madhe në përparimin e qindvjetësishit në të cilin jetojmë – sado që ky i sotëshmi përpiket t'i shpëtojë duke e përballur – i cili po tërhiqet gradualisht drejt saj. Kush e di ndofta, do ta inkorporojë mbrenda suazës së sajë në të ardhëshmen e afërt ose të largët!

Në këtë medium, në të cilin përparimet u mbështetën mbi origjinën fetare mijëra vitëra me radhë, u lindën të dërguarit a prijësat e religjioneve të njohura: n'Egjiptë u lind e u rrit Moiseu, i cili përmbysi kryeneçësinë e Faraonit që predikonte me moton "ene rabbuqumul-aëla"; në Palestinë Isai. Si i pari ashtu edhe i dyti pa dyshuar predikuanë Unitetin Hujnor, megjithëse njerëzit në kohët e errëta të dekadencës e lanë këtë Unitet duke përqafuar dikush një besim dualistik, dikush një besim trinie dhe disa të tjerë një besim pluraliteti.

Ky është një fakt më se i vërtetë. Por, për ta këthyer njerëzinë përsëri drejt Unitetit Origjinal, u pa nevojë të delte një lajmëtar tjetër. Ky ishte Profiti Muhamed (a.s.), i paralajmëruar prej librave të shenjtë e prej devinatorëve të mëparshëm. U lind n'Arabi, e cila rrethohej n'atë kohë prej dy fuqish të ndryshme, të kundërshtuara njëra me tjetrën. Fuqija e Kristjanismës dhe e Magismës, fuqija e Perëndimit dhe e Lindjes, mbrenda qarkut të të cilave përfshiheshin edhe shtete satelite të vegjëla, që i ngjiteshin ose i shtroheshin përshtypjes së tyre. Ishin këto dy fuqira që e rrethojshin Siujdhesën Arabike në vitet e para të të gjashtit qindvjetor. Megjithëse çdo njëra prej këtyre kishte lakmira të mbëdha kolinizimi dhe shtrirjeje, me gjithë mundimin që harxhojshin burra e religjionevet për të përhapur Ftesën në Besimin që ata besojshin,

Siujdhesa mbeti e paprekur sikur t'ishte një Oazie e fortifikuar dhe e sigurtë prej okupimeve dhe kështu do të mbetet gjithnjë e sigurtë dhe larg prej Ftesës Fetare të çdo religjioni që të jetë përveç Islamit. Këjo shfaqje a ky fenomen duket krejt i habitshëm në Historie. Është kështu me të vërtë sikur të mos gjendej diçka që e shpjegon, e cila është pozita që zë Arabia si dhe natyra (fizike) e saj, duke i shtuar këtyre të dyjavet dhe mbresën që këto lënë në jetën e popullatës së sajë, në moralin e tyre, në animet dhe në prirjet e tyre. Në këtë vend lindi Muhamedi, Ditëlindjen e të cilit e festojnë të tërë besnikët anë e kand botës islame sikur vepruamë edhe ne këtu në Shqipërinë tonë të dashur nëpër faltoret e ndryshme.

Pak më lart përmendëm që në kohën kur lindi Profiti më të forta shfaqje të qytetërimit botëror qarkullojshin dy pellgjet e deteve; Mesdhetar dhe të Kuq. Është gjithashtu për të përmendur se Kristjanizmi dhe Jahudismi, n'atë epokë, kishin zënë vend për bri njëra tjetrës në mënyrë që edhe po qe se nuk kishin ndonjë armiqësi të dukëshme në mes të tyre, nuk kishin dashuri të dukëshme ndërmjet njëra-tjetrës. Judenjt përmendshin kryengritjen e Isajt kundra fesë së tyre si edhe të dalurit e tij prej saj, aqë sa punojshin në mënyrë sekrete çdo gjë që të mundeshin për të mprapsur dallgën e Krishterimit që i kishte nxjerrë jashtë tokës së premtuar. Judenjt, gjithashtu, kishin arritur të vendosin edhe n'Arabie disa kolonira, një pjesë e tyre kishte zënë vend në Jemen e një pjesë tjetër në Jethrib. Nga ana tjetër edhe Magismi Persjan qëndronte përballë fuqivet të Krishtere për që këto të mos e kalojshin Euphratin për t'u shtrirë në Perësi; ky veprim forcohej prej fuqisë shpirtërore të tërë sistemeve dhe institucioneve idhujtare kudo që të gjëndeshin. Porse, rënja e Romës dhe zhdukja e pushtetit të sajë, mbassi u çua kryeqyteti në Bizant dhe tëra ato shfaqje zbrëthimi që ndoqën këtë ndryshim, shkakëtuan, provokuan dhe kompromentuan një situatë tjetër, e cila lejoi të shtohen përsëri partirat e krishtere, duke u zënë e vlarë njëra me tjetrën, duke u gremisur prej gradëvet më të larta të besimit, dhe, së fundi, duke u kufizuar mbrendë prangavet të verbalismës si p.sh. të bieseduarit mbi sasinë e shenjtërisë së Merjemës dhe të parësisë së sajë mbi Birin ose mbi parësin e tij mbi të etj, që paralajmëronin se kudo që gjinden shkaktojnë rrokullisjen e çdo gjëje prej të cilës prej të cilë shkaktohenshi edhe i këthejnë njerëzit të bëhen të furishëm e armiq ndaj njëri tjetrit. Ndoth

kështu sepse lehet më një anë thelbi duke u preferuar celfat. Pastaj duke i stivusur celfat mbi thelbin shkaktohet të mëshehurit e qëllimit dhe të së vërtetës. Kjo i bën të pamundur njerëzit për t'i çarë ato perde celfash dhe për t'arrirë qëllimin e duhur. Kështu ndodhte në botën që qarkullonte Arabinë kur lindi Muhamedi. Por, ngjarja më apokaliptike se të gjitha të tjerat ishte ajo e përhapjes s'idhujtarisë si edhe adhurimi yjevet në Siujdhesën Arabike, kaq sa për periudha të gjata njerëzit e kishin ngulur bazën e jetës së tyre mbi këtë idhujtari t'errët.

Vendi i lindjes së H. Muhamedit është Mekka. Qysh prej shumë kohësh më parë flitej përmbi një Profit që do të dukej midis arabëvevet, gjë kjo që në qarqet e ndryshme Mekkase po provokonte disa shqetësime. Ebu Sufjani një ditë pa qortuar Umejje ibn Ebi Saltin sepse ky i fundit përsëriste ato që përmendshin murgjët rreth kësaj çështje. Ndofta kishte të drejtë që qortonte shokun sepse këta murgjër flasin kështu prej padijes që kishin në religjionin e tyre – mendonte Ebu Sufjani. "Janë vetëm këta, thoshte Ebu Sufjani, që kanë nevojë për Profit për t'u spjeguar religjionin; sa për ne, thoshte ai, ne kemi idhujt që na afrojnë te Zoti që t'i përulemi, prandaj s'kemi nevojë për asnjë Lajmëtar të ri. Është gjithashtu detyrë që ngarkohet mbi ne për t'a luftuar çdo bisedim si këtë ose që t'i përngajë këtij. Ebu Sufjani ishte i njohur si më i madhi Sycophante i Mekkës. Kishte të drejtë të fliste kështu, sepse ai fliste me atë fanatizmë dhe passion që kishte për Mekkën dhe për idhujtarinë e sajë, nuk e çmonte aspak se Ora e madhe e drejtimi po trokitte te dera, se Profetësija e Muhamedit (a.s.) po afrohej dhe se prej Arabisë idhujtare, që qe lënë fare pas dore, do të ndriçonte të tërë botën, pa ndryshim, Drita e Unitetit dhe Fjala e Vërtetë.

Gjenealogjia e H. Muhamedit a.s.

Duhet përmendur se nga trangu atëror, H. Muhamedi rrjedh si vijon: Është i Bir'i Abdull-llahut që qe lindur në 545 (M. K.), ky bir'i i Abdul Muttalibit që qe lindur në 497, ky bir'i Hashimit që qe lindur në 464, ky bir'i Abdi Menafit që qe lindur në 430, ky bir'i i Kusajit që qe lindur në 400.

Nga trangu nënëor është bir'i i zonjës së madhe Aminë, kjo e bij'e Vehebit, ky i bir'i Abdi Menafit, ky i bir'i Zuhresë.

Abdull-llahu, mbasi qe martuar me Aminënë, qëndroi në shtëpinë e njerëzve të saj tri ditë, simbas zakonit t'arabëvevet kur bëhej martesë në shtëpinë e nuses. Kur u këthye në Mekkë në shtëpinë e t'atit (Abdul Muttalibit) së bashku me

bashkëshorten, nuk qëndroi gjatë sepse shkoi për tregëti në Damask, duke e lënë të shoqen shtat-zanë. Më lart vendosëm se Abdull-llahu shkoi për tregëti në Damask. Përpara se të kapërcejmë e të përmendim lindjen e Profetit, le të përmendim një fakt tjetër historik; mbassi Abdull-llahu u vonua në udhëtimin e tij disa muaj në Oazze dhe me t'u kthyer prej udhëtimi, u ndal mysafir te dajat e vet në Medine për t'u shlodhur prej udhëtimin të rëndë e të vështirë dhe për t'u kthyer pastaj me karvanin për Mekkë, ra i sëmurë në shtëpi të dajavet dhe shokët e lanë ashtu të sëmurë duke udhëtuar për Mekkë pa të. Kur arritën këtu, lajmëruanë t'atin për sëmundjen me të cilën ishte goditur i biri. Abdul Muttalibi pa humbur kohë dërgoi në Medinë djalin e madh, Harithin, për të marrë të vëllanë e për t'u këthyer së bashku me të në Mekkë. Por, kur Harithi arriu në Medine, u lajmërua se Abdull-llahu kishte ndërruar jetë. Humbja e Abdull-llahut shkatoi dhimbje, mjerim e hidhërim të thellë tek Abdul Muttalibi sepse kishte humbur djalin më të zgjedhur të tij dhe duke pikëlluar e trishtuar zemrën e shpirtin e Aminesë për humbjen e një bashkëshorti, me të cilin shpresonte se do të kalonte një jetë të kënaqëshme dhe të lumtur.

Lindja e Muhamedit a.s

Amineja shtat-zënë vazhdoi kështu edhe për një kohë të caktuar deri sa i erdh koha për të lindur. Kur lindi të birin i dërgoi Abdul Muttalibit në Qabe myzhden se iu lind një nip. Plaku u gëzua kur mori lajmin e madh. Solli menjëherë ndërmend Abdull-llahun, duke ngushëlluar dhimbjen që ndjente për të me trashëgimtarin e tij të vocër. Shpejtoi te e reja, e mori djalin me zili midis dy duarvet, eci me të ashtu deri sa arriti në tempull (Qabe) dhe emëroi Muhamed! Sa do që ky emër nuk përdorej shumë prej arabët, ishte i njohur prej tyre. Pastaj gjyshi ia këtheu fëminë s'ëmës dhe mbet në pritje së bashku me të që të vijnë tajat që mëkojnë qumësht për t'ia dorëzuar njërës prej tyre, simbas zakonit të fisnikëve arabë të popullatës mekkase. Ai iu dorëzua kur ende ishte i njomë një gruaje beduine të quatur Halime, e fisit Beni Saëd. Kështu fëmija filloi të rritet në një atmosferë

beduine, folës i gjuhës së tyre letrare. E ama e tij, Amineja, vdiq kur ai kishte arritur të gjashtin vit të jetës së tij.

H. Muhamedi u lind pra, prej dy prindërvet të vobegtë në pikpamje pasurije por të pasur në pikpamje fisnikërije dhe grade. Me gjithë këtë djemtë e Hashimit ishin kryetarë të Mekkës dhe mbikqyrshin pusin e zemzemit. Abdull llahu vdiq para se të lindi H. Muhamedi. Ky, mbasi lindi, mbeti nën mbrojtjen e gjyshit të tij, Abdul Muttalibit, por, kur edhe ky ndërroi jetë, e morri në dorëzim xhaxhai i tij Ebu Talibi.

H. Muhamedi qe lindur në 570 M. K., simbas mendimit të shumicës së historianëve. Ndërsa të tjerë e llogarisin se i Dërguari është lindur në 20 prill 571 M.K. Këtë mendim ka edhe i ndjeri Mahmud Pasha el Felekiu i Egjyptit. Ky vendos se Lindja e të Dërguarit ka ndodhë n'agimin e ditës së Hënë, në 9 të muajit Rebiul Evvel, vitin e Elefantit, që i përgjigjet 20 prillit të vitit 571 M. K.

Ibn Abbasi thotë se Muhamedi është lindur ditën e Elefantit. Të tjerë vendosin se ai është lindur 15 vjet para ngjarjes s'Elefantit. Të tjerë përveç këtyre arrijnë të thonë se është lindur disa ditë pas Elefantit, ose disa muaj, ose disa vitëra; një tufë e llogarit këtë kohë në 30 vitëra, një tjetër në 70 vitëra.

Në të njëjtën mënyrë ranë në konflikt edhe për kohën në të cilën qe lindur, a u lind ditën apo natën, ashtu si ndryshojnë edhe se në cilin vend të Mekkës u lind. Caussin de Perceval, në librin e tij "Essai sur l'Histoire des Arabes" zgjedh që Muhamedi u lind në 20 gusht të vitit 570, d.m.th. Vitin e Elefantit, në Mekkë dhe në shtëpinë e gjyshit të tij Abdul Muttalibit.

Në të shtatën ditë të Lindjes së tij, Abdul Muttalibi urdhëroi të theren mishëra pastaj ftoi burrat e Kurejshivet, të cilët erdhën dhe hëngrën. Kur e morën vesh se e kishte emëruar me emërin e madh, Muhamed, e pyetën se përse hoq dorë prej emëravet të gjyshërve dhe të stërgjyshërve të tij? U përgjigj: "Desha të jetë i lavdëruar në qiell ndaj Zotit si edhe në tokë prej krijesavet të Tij".

**"Kultura Islame", Nr. 20-21, Prill-Maj 1941**



# HAFIZ ISMET DIBRA (1886-1955)



Hafiz Ismet Dibra lindi në Dibër në vitin 1886, ku kreu mësimet fillestare, pastaj Medresenë, ku mësoi përmendësh Kur'anin e madhëruar, e fitoi titullin Hafiz, një titull i nderuar.

Studimet e larta i kreu në Stamboll, në kryeqytetin e Perandorisë, por edhe pse i ofruan katedrën në një shkollë të lartë të Stambollit nuk qëndroi aty sepse kishte vendosur t'i shërbente Shqipërisë...

Dibra është vendlindja e H. Hafiz Ismet Dibrës, Stambolli është vendi ku bëri studimet e larta, ndërsa Tirana është vendi ku zhvilloi veprimtarinë e tij. Revista "Zani i Naltë" është tribuna ku shpalosi njohurit e tij në fushën e legjisllacionit islam, të filozofisë islame, tefsirit, hadithit, logjikës, teorikës etj. Medreseja e Naltë e Tiranës që institucioni ku ai zbatoi në praktikë edukatën islame dhe mjeshtërinë e mësimdhënies. Kishte një kulturë të gjerë, një qëndrim demokratik dhe patriotik. Zotëronte më së miri gjuhën arabe, perse dhe atë turke (osmane).

Në mars 1923 u zhvillua Kongresi i Parë i Myslimanëve Shqiptarë në Tiranë, duke zgjedhur Kryetar të Bashkësisë Islame, Kryemyftiun Haxhi Vehbi Dibrën. Në tetor të vitit 1923 doli në dritë revista "Zani i Naltë", organ zyrtar i Komunitetit Mysliman Shqiptar. Me 1 mars 1924 iu besua drejtimi i Medresesë në Tiranë z. Qamil Bala dhe në vitin 1930, kjo detyrë iu besua Hafiz Ismet Dibrës, duke u bërë drejtori i dytë i saj. Duke ndjekur traditat e të parit aktivizoi trupin mësimor, personel të përgatitur siç qenë: Hafiz Ali Korça, Haki Sharofi, Sheh Qazim Hoxha etj.

Në Medresenë e Tiranës, përveç lëndëve fetare si Kur'ani, Hadithi, Tefsiri, Fikhu... aty mësohej historia, gjeografia, aritmetika, gjeometria, etj.

Në tërë veprimtarinë e tij ai udhëhoqë nga mësimet e Kur'anit dhe në përshtatje me përbërjen e popullit shqiptar ai nisej nga toleranca në mes besimeve dhe besimtarëve. Medreseja e Tiranës, e drejtuar nga H. Ismet Dibra, ruante dhe vazhdonte traditën e edukimit të nxënësve, krahas asaj të fesë, dhe të frymës patriotike dhe kalitjes së ndërgjegjes kombëtare.

H. Ismet Dibra vizitoi edhe vendet e shenjta në Mekë dhe Medine, duke u bërë Haxhi.

Në vitet '30 të shekullit XX zhvilloi një aktivitet të gjerë intelektual, fetar e patriotik. Janë të përmendura ligjëratat e

tij të njëpasnjëshme që patën për subjekt temën "A ka dyshim në qenien e Zotit?" Në këto ligjëratat Hafiz Ismet Dibra, duke u mbështetur në ajetet e Kur'anit, zbërtheu shumë teza dhe koncepte që në ato vite ishin bërë objekt bisede në qarqet intelektuale. Ligjëratat bënë pjesë në luftën që kleri islam po i shpallte ideve komuniste, që kishin filluar të përhapen në Shqipëri. Hafiz Ismet Dibra iu referua shumë figurave të shquara të rrymave të ndryshme filozofike si: Dekartit, Berksonit, Spenserit etj.

Më vonë ato ligjëratat u botuan në faqet e "Zanit të Naltë" dhe më 1993 u botuan edhe në Miçigan të SHBA-së. Hafiz Ismet Dibra në libër bën thirrje që të shihet e vërteta, të hiqen syzet e errëta. "Me syze të errëta, - shkruan ai, kurrë nuk mund të shikohet e vërteta." I tërë libri argumenton shkencërisht qenien e Zotit dhe na thotë se udhëzimin mund ta marrim vetëm nga Zbulesa e Zotit, nga Kur'ani.

*"Kur'ani nuk është as zbulim imi", shkruan Hafiz Ismet Dibra, "e as thënia ime: çdo lexues e studiues serioz i Kur'anit ka kuptuar se sa më shumë që ecën në leximin e studimin e tij, aq më shumë do të gjejë (me një gëzim të brendshëm) se si ky kuptim i përgjithshëm rritet duke u rritur aftësia e tij për t'i rrokur gjërat. Është si rasti i një alpinisti që, sa më lart ngjitet në mal, aq më larg sheh..."*

Pushtuesit fashistë dhe ata gjermanë, më vonë, i ofruan ofiqe dhe dekorata, por ai, ashtu si më 1919 që nuk pranoi postin e profesorit të katedrës nga Turqia, edhe kësaj radhe nuk pranoi asnjë dekorim, as post. Pushteti komunist, të cilit ai nuk iu nënshtrua, e arrestoi në 1946 në moshën 60-vjeçare dhe e dënoi pa asnjë arsye, por vetëm për bindjet e tij fetare, me 12 vjet heqje lirie, të cilat i bëri si shumë e shumë të tjerë në burgjet e diktaturës komuniste. Kështu u dënuan edhe shumë hoxhallarë të tjerë nga diktatura komuniste, siç ishin Hafiz Ali Korça, Hafiz Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Langu, Hafiz Musa Dërguti, Hafiz Ali Kraja, e shumë fetarë, dijetarë e atdhetar të tjerë...

Hafiz Ismet Dibra ndërroi jetë në Tiranë në vitin 1955, në moshën 69 vjeçare, duke mbetur shembull frymëzimi për botën shqiptare.<sup>1</sup>

1. Për më tepër shih: gazeta "Drita Islame", nr. 3, 1992: 3; nr. 111, 1997: 2-4.

# Efektet biologjike **të telefonit celular**

Telefonat celularë janë kthyer në një nga mjetet më të domosdoshëm të shekullit të 21. Ato përfshihen në një gamë të gjerë shërbimesh dhe përfitimesh, nga porositja e një pice nga shtëpia deri te thirrja e ambulancës për t'i shpëtuar jetën dikujt. Sot fushat e përdorimit kanë përfshirë pothuajse çdo aspekt të jetës së përditshme si për shembull, aplikacione që kontrollojnë pajisjet e kuzhinës për të gatuar diçka, etj. Natyrshëm mund të lindë pyetja: a jemi të sigurt nga celularët? Në të vërtetë, ka arsye të mira për t'u shqetësuar nga valët elektromagnetike të tyre.

Sistemet e sotme të kompanive telefonike operojnë me banda të ndryshme frekuencash. Sistemet europiane përdorin GSM(Global System for Mobile Communications) në bandat 900 MHz - 1800 MHz, ndërsa ato amerikane përdorin 850 MHz - 1900 MHz, frekuenca që përkohet me gjatësinë e valëve të televizionit dhe mikrovalës. Këto gjatësi valësh, që quhen jo-jonizuese, nuk lëshojnë elektrone nga atomet e indeve të gjalla. Për shembull, rrezet X janë jonizuese në atë shkallë që dëmtojnë indet e gjalla.

### Çështje shëndetësore

Valët elektromagnetike mund të ndikojnë mbi indet biologjike të gjalla dhe të shkaktojnë ndryshime me dy mënyra: 1. Duke depozituar energji të mjaftueshme për të ndryshuar strukturën e molekulave organike; 2. Duke depozituar energji të mjaftueshme për të prishur lidhjet normale që ekzistojnë në inde. Sidoqoftë, asnjëra nga këto rrugë nuk duket të ketë efekte aq të fuqishme, sepse energjia e fotonit brenda zonës UHF është shumë më e vogël se energjia e lidhjeve organike apo se energjia që duhet për prishjen e strukturave biologjike. Prandaj, sot, shumë shkencëtarë dyshojnë që valët UHF në nivel subtermal të kenë fuqi për të shkakuar dëmtime të indeve.

Si pasojë e dozave të vogla të ekspozimit, mostrave të vogla të popullatës së studiuar dhe mungesës së llogaritjeve të dozës së rrezatimit, vërtetimi ose jo i dëmtimeve nga valët elektromagnetike është një çështje që i mbetet shkencës së epidemiologjisë (analiza statistike mbi shëndetin).

### Studime epidemiologjike

Studimet epidemiologjike janë kryer në individë të cilët kishin punuar për një kohë të gjatë në ambiente me valë të frekuencave të larta, si për shembull, stacione radarësh. Këto studime nuk ishin ekskluzive për valët e telefonave celularë, por përfshinin një amplitudë më të gjerë valësh. Këto studime u kryen në disa institucione përfshirë Laboratorin e Radarëve të Institutit të Teknologjisë në Massachusetts të SHBA, Forcat Detare dhe Ajrore të SHBA dhe ushtrinë polake. Në këto grupe individësh, studimi u fokusua mbi shfaqjen e sëmundjeve kanceroze dhe vdekshmërinë prej tyre

si pasojë e ekspozimit ndaj valëve elektromagnetike.

Qëllimi ishte të vërtetohej nëse sëmundjet kanceroze ishin si pasojë e valëve apo jo. Në përfundim të studimit rezultoi se nuk kishte të dhëna që mbështesin rrezikun e shfaqjes së kancerit nga ekspozimi në valë elektromagnetike. Si pasojë e mungesës së krahasimit me numrin total të kancerit në popullatë, u sugjerua se valë telefonave celularë nuk kanë efekte të forta mbi zhvillimin e sëmundjeve kanceroze.

Për sa i përket kancerit të trurit, ai kërkon një kohë shumë të gjatë për t'u shfaqur. Studimet e deritanishme epidemiologjike janë afatshkurtra dhe nuk tregojnë rrezik për të ardhmen, ndërsa efekti i valëve mbi trurin tonë mbetet akoma i aprovuar.

### Studimet në kafshë

Kafshët janë një burim tjetër informacioni që potencialisht mund të na japë përgjigje për shqetësimet tona. Eksperimente të ndryshme kanë studiuar minjtë e ekspozuar ndaj niveleve të ulëta të valëve elektromagnetike dhe rezultoi se nuk kishte një lidhje ndërmjet valëve të celularëve dhe sëmundjeve kanceroze.

Në vitin 1999, kompania Motorola ndërmoi një program kërkimor i cili doli në përfundim se ekspozimi i minjve në valë 837 MHz, shumë të ngjashme me ato të celularëve, nuk shkaktonte kancer të trurit. Po ashtu, edhe nga një studim tjetër në prill të vitit 2000, u raportua se valët e vazhdueshme kishin të njëjtin efekt si ato alternative. Por, një studim i vitit 1995 i Universitetit të Washington-it (Seattle) raportoi se ekspozimi i minjve ndaj valëve prej 1 W/kg në të gjithë trupin, mund të shkaktojë këputje të ADN-së në bërthamat e qelizave nervore, e cila është treguese e sëmundjeve kanceroze. Në të vërtetë asnjë studim tjetër nuk ka pasur përfundime të tilla.

Studime të tjera janë fokusuar në aspekte të tjera përveç sëmundjeve kanceroze të trurit. Ato u fokusuan mbi sëmundje të tjera dhe u pa se kishte një rritje të shkallës së sëmundshmërisë nga valët elektromagnetike. Sidoqoftë, kërkimet mbi kafshët treguan se ishin disi larg nga shëndeti njerëzor.

### Përfundim

Rezultatet epidemiologjike dhe studimet në kafshë nuk kanë vërtetuar, as nuk i kanë hedhur poshtë efektet e celularëve mbi shëndetin tonë. Një deklaratë e muajit shkurt 2000 nga FDA (U.S. Food and Drug Administration) pohoi se: Për momentin nuk ka të dhëna të mjaftueshme në baza shkencore për të thënë se valët elektromagnetike janë të rrezikshme ose jo për shëndetin e njeriut. Kërkimet janë gjithmonë në vazhdim e sipër.

Përktheu: Erion Sukaj

# DISA ÇËSHTJE RRETH ABDESIT TE GRATË

## **A lejohet gruas të marrë abdes në ambiente publike?**

Një grua mund të marrë abdes në ambiente publike. E rëndësishme gjatë marrjes së abdesit është që meshkujt të mos i shohin pjesët intime. Prandaj, nëse një grua i kushton vëmendje mbulesës, ajo mund të marrë abdes në vende të ndryshme. Nëse në zonën e abdesit ka burra të huaj dhe ajo nuk mund të gjejë vend më të përshtatshëm për abdes, atëherë duhet të marrë abdes pa ua treguar pjesët intime meshkujve të huaj, sepse në aspektin fetar kjo është e ndaluar.

## **A e pengon kënjaja abdesin dhe guslin?**

Ajo që mbetet në gjymtyrë pas përdorimit të kënasë është vetëm ngjyra. Kënjaja nuk pengon depërtimin e ujit në lëkurë, në thonj dhe në flokë. Prandaj përdorimi i kënasë nuk e pengon abdesin.

## **A e pengon boja e flokëve abdesin dhe guslin?**

Në këtë rast është e rëndësishme të dimë përmbajtjen e bojës. Nëse boja ka në përmbajtjen e saj përbërës, të cilët formojnë një shtresë në lëkurën e kokës dhe e pengon ujin të arrijë në lëkurë, atëherë abdesi dhe gusli nuk quhet. Siç e dimë gjëja kryesore në abdes dhe gusl është që uji të arrijë në gjymtyrët që duhet të lahen. Çdo gjë që e pengon këtë kontakt, pengon abdesin dhe guslin.

## **A e pengon abdesin dhe guslin përdorimi i produkteve kozmetike?**

Makiazhi dhe manikyri pengojnë kontaktin e ujit me gjymtyrët, duke penguar kështu edhe abdesin dhe guslin. Ata që përdorin produkte që formojnë një shtresë siç është manikyri, buzëkuqi, rimeli, etj, duhet t'i eliminonjë këto substanca para se të marrin abdes dhe gusl. Këtu mund të thuhet një kriter i përgjithshëm: Të gjitha substancat që pengojnë ujin të prekë lëkurën, parandalonjë abdesin dhe guslin. Pra, të gjitha produktet kozmetike duhet të vlerësohen sipas këtij kriteri të përgjithshëm.

## **A bëhet i pavlefshëm abdesi nëse gruaja prek burrin?**

Sipas Medhhebit Shafi, nëse një burrë dhe një grua, të cilëve nuk u ndalohet martesë, prekin trupin e njëri-tjetrit pa pengesa, si rroba apo dorashka, me vetëdije apo pa vetëdije, abdesi i të dyve prishet. Kur një grua preket nga burra, të cilëve u

është ndaluar përgjithmonë të martohen me të, si babai, vëllai biologjik apo vëllai i qumështit, abdesi i saj nuk prishet. Prekja e thonjeve dhe e flokëve nuk e prish abdesin.

Sipas Medhhebit Hanefi, abdesi nuk prishet nëse një burrë dhe një grua prekin njëri-tjetrin. Nëse njëri prej tyre është hanefi dhe tjetri shafi, atij që është nga Medhhebi Shafi i prishet abdesi.

Pavarësisht përkatësisë së Medhhebit Hanefi, duke qenë se sipas Medhhebit Shafi kontakti i thjeshtë fizik mes dy gjinive e prish abdesin, të veprsh sipas këtyre të fundit është më e përshtatshme për besimtarët e dedikuar ndaj fesë.

## **A e prishin abdesin sekrecionet e bardha te gratë?**

Në burimet tona të fikhut çdo gjë që del nga organet e jashtëqitjes e prish abdesin. Megjithatë, ka disa përjashtime nga kjo. Një prej tyre është sekrecioni i bardhë. Lagështia që vërehet në organet gjenitale të gruas, në burimet tona quhet "rutubetu'l-ferxh" dhe përshkruhet si një rrjedhje e bardhë midis djersës dhe lagështisë.

Juristët janë të mendimit se rrjedhja që vjen nga thellësia e pjesëve intime të gruas (për shembull, nga mitra) është e papastër. Sipas shumicës së studiuesve, lagështia që shfaqet jashtë organeve gjenitale dhe nuk vjen nga thellësia e mitrës është e pastër. Ajo që nënkuptohet me shprehjen jashtë pjesëve intime është zona që duhet të lahet gjatë guslit dhe istinxhasë (pastrami i tualetit).

Sipas shumicës së studiuesve, sekrecionet e bardha nga pjesët intime të gruas (me kusht që të mos vijnë nga organet gjenitale) janë të pastra. Meqenëse gjërat e pastra, që dalin nga trupi nuk e prishin abdesin, as kjo rrjedhje nuk e prish abdesin. Kjo vlerësohet si lëngjet e tjera të pastra që dalin nga trupi i njeriut, siç janë djersa, lotët dhe pështyma. Megjithatë është e nevojshme të dihet nëse ky lëng i bardhë vjen nga thellësia (d.m.th., si rezultat i epshit) dhe gjithashtu t'i kushtohet vëmendje nëse përmban inflamacion. Nëse vjen si epsh apo është inflamacion, është i papastër dhe e prish abdesin. Ndonjëherë kjo mund të kuptohet nga era dhe ngjyra e tij. Kur nuk kuptohet ose keni dyshime mbi këtë, për të qenë të sigurt, duhet të konsultoheni me ndonjë mjek. Gratë të cilat nuk arrijnë



të dalin në një konkluzion në lidhje me rrjedhjen, dhe kjo situatë do t'i shkaktojë atyre vesvese, mund të vendosin që rrjedhja e lëngut të jetë e pastër dhe të sillen normalisht në mënyrë që të mos bëhet viktimë e vesvesesë dhe të mos e bëjnë këtë çështje të pazgjidhshme, sepse feja jonë është fe e lehtësimit. Gratë që mendojnë se rrjedhja është e papastër, nëse kanë mundësi të marrin në çdo vakt abdes, me kusht që të mos bien pre e vesvesesë, duhet të përpiqen të mbrojnë ndjeshmëritë e tyre.

#### **A e pengon tatuazhi abdesin?**

Bërja e një tatuazhi në trup nuk është e lejuar në fenë tonë. Nëse personi e ka bërë tatuazhin para shumë kohësh dhe tashmë është pënduar për këtë vëprim, duhet të përpiqet ta fshijë atë. Nëse tatuazhi është një kryq apo ka formën e dickaje që është në kundërshtim me moralin duhet hequr nga trupi me patjetër. Nëse këto tatuazhe nuk mund të hiqen, atëherë përgjegjësia e personit është që t'i drejtohet Allahut me pendesë dhe për falje, duke i kërkuar falje për këtë ndërhyrje të panevojshme, që ka bërë në trupin e tij, i cili është një amanet nga ana e Allahut. Sa i përket çështjes së pengimit të abdesit, tatuazhi nuk e pengon as abdesin dhe as guslin, për shkak se boja nuk gjendet mbi lëkurë por ndodhet nën të.

#### **A bëhet i pavlefshëm abdesi i personit që pastron pelenën e foshnjës?**

Situatat që e prishin abdesin kanë të bëjnë kryesisht me vetë personin. Ndotja e njëriut me papastërti nga jashtë, nuk e ndikon abdesin. Por nëse personi që është i ndotur me papastërti do të falë namaz, nuk mund të falet pa i larguar papastërtitë. Nëse falet pa larguar papastërtitë nga trupi apo rroba e tij, namazi nuk është i vlefshëm. Nëse ndotemi gjatë ndërrimit të pelenës së foshnjës, abdesi nuk priset. Por nëse do të falim namaz është e detyrueshme të largohet papastërtia nga trupi apo rroba, në të kundërt e bën namazin të pavlefshëm.

#### **A janë të papastra urina dhe të vjellat e foshnjës?**

Sipas Medhhebit Hanefi urina dhe e vjella me gojën plot tek fëmija është e papastër. Nëse urina që futet në rrobë ose në trup është më e madhe se gjerësia e pëllembës së dorës, është e nevojshme të pastrohet. Për papastërtitë e lëngshmë përdoret matja nëpërmjet gjerësisë së pëllembës së dorës. Nëse e vjella

është e lëngshme, i nënshtrohet rregullit të papastërtive të lëngshme. Nëse është e ngurtë, tolerohen 3 gram dhe më shumë se 3 gram janë konsideruar të nevojshme për tu pastruar. Nëse nuk pastrohet, e pengon namazin por jo abdesin. Profeti ynë (a.s) ka thënë: Shmangni urinën, sepse shumica e mundimit në varr shkaktohet nga ajo. Këtu nuk përjashtohet urina e fëmijës.

Të vjellat që nuk dalin me gojën plot, nuk konsiderohen papastërti e rëndë sepse ato nuk vijnë prej stomakut. Lëngjet që vijnë prej stomakut janë të papastra.

#### **A bëhet i pavlefshëm abdesi i gruas që ushqen foshnjën me gji?**

Që të priset abdesi i njeriut duhet të dalin nga trupi i tij urina, jashtëqitjet, gjaku, qelbi, ndonjë lëng nga rrugët e jashtëqitjes, etj. Kurse qumështi që vjen nga gjiri i nënës konsiderohet i pastër dhe nuk e prish abdesin.

#### **A mund të bëhet mes'h mbi mbulesën e flokut?**

Mbulesa nuk e zëvendëson flokun. Njëkohësisht ajo nuk është si një fashë që aplikohet mbi një plagë. Prandaj mes'hu mbi mbulesë nuk e zëvendëson mes'hun mbi flokë, i cili është prej obligimeve të abdesit. Gjatë marrjes së abdesit, duhet të bëhet mes'h mbi kokë.

Nëse gruaja është në një ambient ku nuk e heq dot mbulesën, atëherë e liron atë sa të jëtë e nevojshme për të bërë mes'h në kokë.

#### **A lejohet që gratë të bëjnë mesh mbi çorape në rastin kur ato e kanë të vështirë ti heqin ato?**

Duke qenë se sipas një prej qasjeve të Medhhebit Hanefi mes'hu mbi çorape të thjeshta lejohet, ne shohim që në vitet e fundit kjo është kthyer një praktikë mjaft të aplikuar. Përtej kësaj, sipas mendimeve bazë dhe të njohura të të katër medhhebeve, nuk lejohet të bëhet mes'h mbi çorape. Mes'hu lejohet vetëm mbi meste. Çorapet duhet të hiqen dhe të lahen këmbët. Kush dëshiron të marrë mes'h mbi çorape, e ka një zgjidhje. Zgjidhja është të vishen meste. Këmbëngulja që të bësh mes'h mbi çorape sepse është sunet, nuk duhet t'na ngatërrojë, duke qenë se larja e këmbëve është farz dhe ka më shumë sevap.

# Respekti ndaj emrit të Muhamedit (a.s.)

Ky është një tregim i cili dëshmon më së miri për respektin ndaj veprës, karakterit dhe emrit të Muhamedit a.s. të brezave të vjetër myslimanë.

Thuhet se një nga kalifët e nderuar në mesin e shoqëruesve të tij kishte një djalë të zgjuar dhe të ndershëm që quhej Muhamed. Djali i zbatonte me zell e korrektësi urdhrat e kalifit, dhe për këtë fitoi simpati të madhe.

Kur Kalifi e urdhëronte për diçka, e fillonte me emrin e tij të bukur, duke i thënë: "Muhamed, bëje këtë dhe këtë ...!" Të dy ishin të kënaqur: djali, sepse kishte një zotëri të tillë, ndërsa kalifi, sepse gjithmonë mund të mbështetej te djaloshi besnik.

Por, një ditë ndodhi diçka e papritur. Duke i dhënë urdhrat e zakonshme, në vend që t'i drejtohej në emër, kalifi i tha: O djalosh! Muhamedi mbeti i shtangur, dhe mendoi se ka diçka që nuk shkon. Kurrë më parë kalifi nuk i qe drejtuar në këtë mënyrë. Ditët kalonin, ndërsa djalin e mundonte shumë ai moment. Këtë e hetoi edhe babai, i

cili një ditë e pyeti se pse ishte aq i dëshpëruar. Fillimisht djali ngurroi, por pastaj i tregoi babait arsyen e vërtetë.

- Baba, ti je mik i ngushtë i kalifit, të lutem pyete pse m'u drejtua në atë mënyrë? - i tha djali me lot në sy. Babai e ledhatoi dhe me një buzëqeshje të lehtë i premtoi se shumë shpejt do ta sqarojë këtë çështje.

Dhe vërtetë ashtu ndodhi. Një ditë, i ati u gjet i vetëm me kalifin dhe e pyeti për shqetësimin e djalit. Kalifi e dëgjoi me kujdes, por në vend që t'i shpjegohej, ai i kërkoi që nesër të vinte së bashku me djalin. Kjo gjë e shqetësoi edhe më shumë djalin, i cili tërë natën nuk vuri gjumë në sy.

Në mëngjes herët, Muhamedi me babain shkuan te kalifi.

- Më thuaj Muhamed, çfarë të mundon? i tha Kalifi  
- Babai jua ka thënë të gjitha, ia ktheu i emocionuar djali.  
- Po, por unë dua ta dëgjoj prej teje. Deri më sot, më ke dëgjuar ti mua, kurse tani dua të dëgjoj unë ty.  
Djali me zërin që i dridhej ia tregoi shqetësimin e tij, dhe



priti përgjigjen e Kalifit. Kalifi u ngrit, shkoi ngadalë deri te dritarja dhe hodhi sytë nga minaret e xhamive.

- Ai e di ti, Muhamed, se emri yt përmendet pesë herë në ditë në ato minare?, - e pyeti kalifi.

- E di, - tha djali me zë të ulët.

- A mund të më thuash se kush ishte Muhamedi?, - tha kalifi.

- Pejgamberi ynë dhe krenaria jonë, i biri i Allahut dhe Emine, atij që i është zbritur Kur'ani i Shenjtë, model për të gjithë ne që e pasojmë.

- I mençur dhe i ndershëm je ti, Muhamedi im, - vazhdoi Kalifi, - ashtu siç është i mençur dhe i ndershëm edhe babai yt, Abdulkrimi, që të vendosi një emër kaq të bukur. Nuk e kam menduar që vetëm pse të quajta djalosh do të shqetësonte aq shumë, por në anën tjetër, unë jam i kënaqur që ndodhi kështu. A ke menduar pse vepra kështu? pyeti Kalifi.

Në vend të përgjigjes djali uli kokën.

-Shiko, Muhamed, Allahu t'i ka dhënë të gjithë të mirat.

Unë nuk do të mësoj e as nuk do të kritikoj, sepse nuk ke bërë asgjë të gabuar. Në vend të kësaj, do të zbuloj një sekret të cilin nuk ia kam treguar askujt. Të gjithë ato që i the për Muhamedin, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i ke thënë shumë bukur. Ai njëherë pati thënë se ne nuk do të jemi besimtarë të vërtetë derisa ai të mos jetë më i dashur për ne se vetja jonë. E tani, unë mundohem të jem sa më i mirë, duke ndjekur atë që ai e ka bërë, dhe t'i shmangem asaj që ai e ka ndaluar, e në fund Allahu do të na llogaritë veprat tona. Unë po të them diçka. Emri yt, që është edhe emri i Pejgamberit tonë të dashur, është më i zgjedhuri dhe më i bukuri, prandaj unë kurrë nuk e kam përmendur pa pasur abdes. Atë ditë ndodhi që të jem pa abdes, prandaj të quajta djalosh, e jo Muhamed, siç kam vepruar zakonisht.

Djali mbeti i heshtur, por i gëzuar nga fjalët e kalifit.



# **PROGRAMET MASTER**

**Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike**

**Master Shkencor në Drejtësi**

Profili e Drejtë Penale

Profili e Drejtë Ndërkombëtare

**Master Shkencor në Shkenca Komunikimi**

Profili Marrëdhënie Publike

Profili Gazetari

**Master Profesional në Komunikim Marketingu**

**Master Shkencor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze**

**Master Profesional në Mësuesi - Gjuhë Angleze**

Profili Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë

Profili Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët

**Master Shkencor në Shkenca Islame**

**Master Shkencor në Studime Religjioze**

Profili Dialog Ndërfetar

Profili Edukim Fetar

Profili Lidërsip Fetar